

OBAMA I MAQEDONISË APO PLATFORMA E TIRANËS

*SI TË FITONI VOTA NGA
„TË TJERËT” DHE ÇFARË MË TEJ?*



OBAMA I MAQEDONISË APO PLATFORMA E TIRANËS:
SI TË FITONI VOTA NGA „TË TJERËT” DHE ÇFARË MË TEJ?

CONTENTS

1.	HYRJE	6
2.	STUDIM RASTI: IMER SELMANI- OBAMA I MAQEDONISËA	9
3.	STUDIM RASTI: „AKTRIM I PANEVOJSHËM I PATRIOTIZMIT” APO LSDM NË PËRPJEKJE PËR T’I FITUAR VOTAT E „TË TJERËVE”	18
4.	OBAMA I MAQEDONISË APO PLATFORMA E TIRANËS	32
5.	KONSTATIMET DHE SI MË TEJ?	35

OBAMA I MAQEDONISË APO PLATFORMA E TIRANËS: SI TË FITONI VOTA NGA „TË TJERËT” DHE ÇFARË MË TEJ?¹

REZYME:

Fitimi i votave nga komuniteti „tjetër”, të „votuesve maqedonas dhe shqiptarë” nga kandidatët dhe partitë „shqiptare dhe maqedonase” nuk është mision i pamundur. Me mesazh dhe fushatë joshëse Imer Selmani në vitin 2009 dhe LSDM në vitin 2016 arritën të fitojnë numër të konsiderueshëm të votave nga „të tjerët”. Selmani nuk arriti ta përsëris suksesin zgjedhor në ciklet e radhës, ndërsa është e diskutueshme nëse LSDM do e arrijë atë në të ardhmen. Në afat të shkurtër, përfitimet e Selmanit dhe LSDM-së ishin të mëdha. Selmani fitoi popullaritet dhe nëse do të vazhdonte me mesazhet dhe paraqitjet në frymën e fushatës së tij presidenciale, partia e tij Demokracia e Re do të mund të shpresonte për shfaqje të fuqishme në zgjedhjet parlamentare të radhës në pozitë që të vendoste për përbërjen e koalicionit qeverisës, gjegjësisht të ishte pjesë e së njëjtit. LSDM-ja në afat të shkurtër, me votat e shqiptarëve dhe me numrin e shtuar të votave nga komunitetet e tjera etnike, romë, turq, boshnjakë të cilat i fitoi në zgjedhjet e vitit 2016 u përafrua me fituesin e zgjedhjeve VMRO-DPMNE-në. Si përfundim, pas dështimit të negociatave mes partisë së Nikolla Gruevskit dhe BDI-së, arriti të krijojë qeveri. Pa votat e shqiptarëve LSDM do kishte më pak deputetë dhe marrëveshjet për koalicion dhe krijimin e qeverisë pas zgjedhjeve do të ishin shumë më komplekse, gjë që do i jepte VMRO-DPMNE-së më shumë mundësi për marrëveshje me partnerë nga disa parti „shqiptare”.

Është e rëndësishme që pas suksesit të Imer Selmanit, Maqedonia nuk u fokusua në ndërtimin e politikave, programeve politike dhe fushatave multikulturore. Suksesi i LSDM-së tregoi se kërkesat për, gjegjësisht ofrimi i ngritjes së statusit të një komuniteti etnik, mund të jetë mjet për sukses zgjedhor. Ky sukses, nga ana tjetër, kontribuoi në radikalizimin e gjendjes si tek përfaqësuesit e shqiptarëve etnik ashtu dhe të maqedonasve etnik, si dhe të komuniteteve më të vogla etnike. Kështu që, shoqërisë maqedonase i nevojitet reformë në sistemin politik dhe zgjedhor në drejtimin integruar. Ngjarjet e viteve 2016 dhe 2017 treguan se shoqëria jonë nuk është e pjekur për kandidatë që ofrojnë programe të pranueshme për të gjithë qytetarët pa dallim të prejardhjes etnike. Konfliktet ndëretnike në Maqedoni nuk janë tejkaluar. Na nevojiten teknika të reja për parandalimin e konflikteve etnike menjëherë, edhe atë që në zgjedhjet presidenciale të radhës në vitin 2019.

¹ Autorë të studimit janë 1. Prof. Zhidas Daskalovski, 2. Kristijan Trajkovski, dhe ekipi i Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave. www.crpm.org.mk.

1.

HYRJE

Shtet shumë-etnik i së drejtës është ai i cili krijon komb qytetar si përmbledhje e gjithë komuniteteve që jetojnë në vend, ku njihen të gjitha traditat dhe kulturat, ku qytetarët nga komunitetet pakicë të cilët duan që kultura e tyre të mbijetojë dhe të zhvillohet janë të mbështetur nga shteti, ku të gjithë qytetarët dhe jo vetëm ata të shumicës e respektojnë sistemin e drejtësisë dhe institucionet, dhe ku pakicat ndjejnë që shteti është edhe i tyre. Shteti i tillë, gjegjësisht kombi qytetar, është rëndë për t'u ndërtuar sepse kërkon harmoni në marrëdhëniet mes komuniteteve. Në praktikë, krijimi i harmonisë mes grupeve të ndryshme etnike është proces i mundimshëm, sizifian. Gjegjësisht, konfliktet politike për pushtet dhe kontroll mbi institucionet shtetërore janë shumë më të shpeshta mes grupeve të ndryshme etnike. Për shkak të rrezikut nga përshkallëzimi i konflikteve deri në shkallë të përplases mes dy popujve dhe luftës qytetare, politikologët mundohen të gjejnë mënyrë për t'i zbutur ose tejkaluar ato. Ekzistojnë dy modele normative të menaxhimit me konfliktet etnike – konsocializmi dhe modeli integruar. Edhe pse modelët janë paramenduar në raport me problemet rreth ndërtimit të kombeve në shoqëri skajshmërisht të ndara në Evropën perëndimore (teoria e Liphardit për konsocializëm) dhe në raport me gjendjen në shtetet e sapoformuara në Afrikën post-koloniale (sistemi integruar i Horovicit), ato ngelen relevante për zgjidhjen e çështjeve etnike në vendet e bllokut ish-socialist, siç është shembulli me Maqedoninë dhe më gjerë.²

Konsocializmi sipas Liphard dhe modeli integruar i Horovicit predikojnë të ashtu-quajturën ndarje të pushtetit. Ndarja e pushtetit është mekanizëm gjithëpërfshirës i cili jo vetëm që garanton përfaqësim politik dhe pjesëmarrje në institucionet e sistemit, por garanton edhe qeverisje të përbashkët, gjegjësisht vendimmarrje të përbashkët të grupeve të ndryshme etnike. Këtu në një farë mënyre neglizhohet sistemi i vendimmarrjes me shumicë. Një nga definicionet e përgjithshme të Timoti Sisk (Timothy Sisk) i cili i definon sistemet e ndarjes së pushtetit si „...të tilla që synojnë drejt krijimit të koalicioneve inkluzive, gjithëpërfshirëse në të cilat marrin pjesë shumica e, nëse jo të gjithë grupet etnike në një shtet”.³ Ideja kryesore e sistemeve të ndarjes së pushtetit është se kualiteti demokratik është më i madh nëse bazohet në konsensus të gjerë të interesave të ndryshme, gjegjësisht se parimi i shumicës është i papërshtatshëm në shoqëri të ndara sepse shpesh here në sisteme të tilla grupi ose partia e cila fiton 51% të votave dominon mbi të tjerët. Kështu, komunitetet pakicë nuk përfaqësohen dhe qëndrimet e tyre nuk merren parasysh

2 Arendt Lijphart, *Democracy in Plural Societies*, Yale University Press, 1977, dhe Donald Horowitz, *Ethnic Groups in Conflict*, University of California Press, 1985;

3 Timothy D. Sisk, *Power Sharing and International Mediation in Ethnic Conflicts* (Washington: US Institute of Peace & Carnegie Commission on Preventing Deadly Conflict, 1996), faqja 4.

gjatë sjelljes së vendimeve, janë të përjashtuara nga „loja”, mund të jenë të diskriminuara, mund të jenë të pakënaqura nga institucionet, të krijojnë institucione paralele etj.. Me një fjalë, stabiliteti i vendit vihet në pikëpyetje.

Konkretisht, me modelin integruës synohet drejt krijimit të faktorëve motivues që liderët politik të jenë më të matur në veprimet dhe vendimet e tyre, gjegjësisht të krijohet një klimë e sjelljeve dhe vendimeve të matura për tema të ndjeshme ose të nxehta që kanë të bëjnë me çështjet etnike. Modeli integruës themelohet në motivimin e komuniteteve të ndryshme për bashkëpunim ndëretnik përmes sistemeve zgjedhore që nxisin formimin e pakteve parazgjedhore mes partive politike ose kandidatëve presidencial me prejardhje të ndryshme etnike. Do të ishte ideale sikur interesat e tyre të përafrohen deri në atë nivel sa të arrihet bashkimi i partive të ndryshme në një më të madhe e cila do të kishte karakter shumë-etnik, që rrjedhimisht do të bazohej në nevojat për tu realizuar interesat e përbashkëta publike, gjegjësisht interesa që i tejkalojnë kërkesat etnike. Programet zgjedhore të një partie të tillë do të fokusoheshin në çështjet ekonomike dhe shoqërore ose në politikën rajonale gjatë ndarjes së resurseve publike. Është e qartë se në vendet ku elektorati është i ndarë në bazë etnike nuk është e lehtë të binden liderët partiak të bëjnë zgjidhje me kompromis dhe paraqitje të përbashkëta. Prandaj, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet vendosjes së kornizave ligjore të cilat në mënyrë sistematike do të nxisin sjellje të matura dhe bashkëpunuese të elitave politike etnike. Sistemet zgjedhore duhet të vendosen në atë mënyrë që t'i nxisin marrëveshjet ndëretnike dhe të ashtuquajturin akomodim ndëretnik (accomodation).⁴

A i nevojitet Maqedonisë reformë e tillë e sistemit politik dhe zgjedhor? A është e pjekur shoqëria jonë dhe a i tejkalon barrierat etnike gjatë votimit, gjegjësisht a ofrojnë partitë dhe kandidatët programe që janë të pranueshme për të gjithë qytetarët pa dallim prejardhjes etnike? Nëse po, atëherë a është Maqedonia një nga rastet e rralla shumë-etnike ku mund të pritët se konfliktet janë tejkaluar, më saktë se do të minimalizohen? Këtu do të analizojmë shembuj nga fushata të partive dhe kandidatëve të cilat kanë arritur t'i tejkalojnë barrierat etnike dhe të tërheqin vota nga „tjetri”. Do i shpjegojmë metodat dhe mënyrat e veprimit që të mund të sjellim përfundim në lidhje me modelin integruës dhe nevojën për aplikimin e këtij modeli në Maqedoni.

Në parim, tejkalimi i barrierave etnike për përfitimin e votave në zgjedhje nga „të tjerët” në shoqëri të përziera etnike është mision i rëndë. Shembujt nga fqinjët, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova ose Bullgaria, si dhe ato nga Irlanda Veriore, Belgjika ose Spanja tregojnë se në shtetet ku antagonizmi mes grupeve etnike është më i madh, kjo thuhet se është e pamundur. Në Maqedoni, pasi që në zgjedhjet parlamentare LSDM dhe VMRO-DPMNE parimisht përfshijnë parti që i përfaqësojnë interesat e të ashtuquajturave komunitete më të vogla, turq, romë, serb, boshnjak, partitë e mëdha kushtimisht thënë „maqedonase” gjithmonë marrin vota nga këto komunitete etnike. Votimi i maqedonasve për „parti shqiptare” dhe anasjelltas është çështje tjetër. Përveç disa rasteve përjashtuese, si për shembull zgjedhjet presidenciale në vitin 1999 kur një numër i konsiderueshëm i votave në rrethin e dytë

⁴ Për më shumë, vizito Sisk 1996 ose Reilly, B. (2001) *Democracy in Divided Societies: Electoral Engineering for Conflict Management*. Cambridge: Cambridge University Press, si dhe në pjesët e Horowitz, D. L. (1985) *Ethnic Groups in Conflict*. Berkeley, CA: University of California Press, *A Democratic South Africa? Constitutional Engineering in a Divided Society*. Berkeley, CA: University of California Press 1991, dhe *The Deadly Ethnic Riot*. Berkeley, CA: University of California Press, 2001.

për Boris Trajkovskin ishin nga shqiptarë etnik, por për të cilat kishte dyshime të arsyeshme për parregullsi, këto raste janë të rralla kur bëhet fjalë për votimin nga ana e shqiptarëve të Maqedonisë për kandidat „maqedonas” dhe anasjelltas. Duke pasur parasysh qëllimin tonë, në këtë studim do të paraqesim rastet e suksesshme të mobilizimit të votave nga „ të tjerët (shqiptarë/maqedonas) si kandidati presidencial Imer Selmani në vitin 2009 dhe LSDM-ja në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016. Cilat janë arsyet dhe teknikat e „gjuajtjes” së votave të tilla, cili është suksesi dhe perspektivat për përsëritjen e këtij suksesi?

2.

STUDIM RASTI: IMER SELMANI- OBAMA I MAQEDONISË

Në vitin 2009 u mbajtën zgjedhjet presidenciale dhe lokale. Kandidat për president ishte edhe Imer Selmani. Në vitin 2000 ai u zgjedh kryetar i komunës së Sarajit në Shkup, ndërsa nga viti 2003 ka qenë nënkryetar i PDSH-së. Në Qeverinë e VMRO-DPMNE-së dhe PDSH-së (2006-2008) Selmani ka qenë ministër i Shëndetësisë, ndërsa në nëntor 2008 ai doli nga PDSH-ja dhe e formoi partinë Demokracia e re/Нова демократија (DR/НД).

Gjatë formimit të DR-së, opinioni i përgjithshëm ishte se kjo ishte partia e parë e formuar nga një shqiptar i Maqedonisë me „shenja qytetare”⁵. Në të thuhej se „inter-

sat e shqiptarëve do të jenë në plan të parë, por përmenden edhe komunitetet e tjera”⁶. Megjithatë, gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009 u vërtetua se Imer Selmani kishte ambicie që i tejkalojnë kufijtë etnik. I inspiruar nga rasti amerikan i zgjedhjes së një presidenti me prejardhje nga një komunitet etnik pakicë ai „besonte se pas shembullit të Obamës edhe në Maqedoni qytetarët mund të votojnë për kandidat nga një komunitet tjetër më i vogël etnik”. Ai e paraqiti veten si bartës i një opsioni të ri, jo vetëm tek shqiptarët e Maqedonisë, por dhe tek maqedonasit dhe komunitetet e tjera etnike.⁷ Zgjedhjet presidenciale në vitin 2009 u mbajtën në të njëjtën kohë me ato lokale, ndërsa mesazhi kryesor i Selmanit dhe i partisë gjatë zgjedhjeve ishte „Pranverë e re – demokracia e re”.



5 Gazeta Vest 09.17.2008 numër: 2476: Imer Selmani e promovoi Demokracinë e re (burimi në internet: <http://star.vest.com.mk/default.asp?id=157076&idg=8&idb=2476&rubrika=Makedonija>)

6 Svetlana Unkovska – Utrinski vesnik 16.09.2008: Demokracia e re, proces që ekziston (burimi në internet: <http://utrinski.mk/?ItemID=9202DBB33CD38C4ABA1C9B8F6E304C35>)

7 Svetlana Unkovska – Utrinski vesnik 13.02.2009: Ambiciet e mëdha të Imer Selmanit (burimi në internet: <http://utrinski.mk/?ItemID=15A72DEFBC94834AA4A2E7B14F8B4A15>)



„Имаме средби во чајилници, на фарми, на градилишта, на плоштади, на средсело, во кафулиња и ресторани. Ја прошетавме цела Македонија од Струга до Струмица и од Тетово до Штип. Само така можеме да допреме поблиску до гласачите и да ја пренесеме пораката на обединување и демократија на тие кои сеуште се колебаат... Јас сакам да сум претседател на Македонија за кого ќе гласаат не само Албанците, туку и сите други Македонци, Турци, Власи, Срби, Бошњаци.“

Срекен сум да Ви ја најавам новата пролет за Македонија.

Ваш,
Имер Селмани

I. Selmani



Fushatën e tij presidenciale ai e filloi në Manastir, qytet i rëndësishëm për krijimin e alfabetit dhe kulturës shqiptare, por me popullsi kryesisht maqedonase. Mesazhi që u përçua ishte për ndërtimin e Maqedonisë moderne, të bashkuar brenda dhe të respektuar ndërkombëtarisht. Potencohej qasja qytetare drejt politikave: „Planet dhe projektet e dizajnuara nga unë dhe ekipi im profesional bazohen në problemet e secilit qytetar në Republikën e Maqedonisë...“⁸ Selmani e tërhoq trupin votues maqedonas drejt idesë së tij; „... Më në fund në Maqedoni erdhi koha të thyhen barrierat dhe stereotipat etnike. Le të mos ju gënjejnë se është herët që në krye të shtetit të qëndrojë shqiptar, se koha do të vijë në vitin 2014...“ Nuk ka ç’të pritet, koha është tani. Në vitin 2009 mund të votojmë njeri të aftë në krye të shtetit i cili mund të na bashkojë dhe do t’i për-

faqësojë të gjithë qytetarët. Më datë njëzet e dy t’i dërgojmë mesazh të qartë botës – Maqedonia qëndron e bashkuar dhe e fuqishme!“⁹ Në komuna kryesisht maqedonase Selmani ishte i drejtpërdrejtë. Në Prilep, më 15 mars, 2009 ai tha: „Unë paralajmëroj pranverë të re në Maqedoni. Pranvera në Maqedoni do të fillojë kur të bashkohemi, kur t’i tejkalojmë barrierat etnike, kur të kemi besim të mjaftueshëm do të jemi të gatshëm të votojmë për kandidat nga një grup tjetër etnik sepse besojmë se ai më së miri do i përfaqësojë interesat e shtetit!“¹⁰

Në Kavadar, Strumicë, Radovish dhe Shtip Selmani potenco: „Ju duke ju bindur se nuk është koha, nuk mundemi tani. Ju gënjejnë! Udhëtoj nëpër Maqedoni dhe jam i bindur se shqiptarët, maqedonasit, turqit, boshnjakët, romët dhe vllahët janë gati tani, në vitin 2009 të votojnë për kandidat shqiptar, për Imer Selmanin! Qytetarët janë gati të votojnë për personin dhe jo për partinë! Vetëm unë mund të arrij zhvillim ekonomik përmes bashkimit të brendshëm dhe integritetit të Maqedonisë në BE dhe NATO!“¹¹



8 Broshurë – Kandidat presidencial Imer Selmani.

9 E njëjta.

10 E njëjta.

11 E njëjta

Një shqiptar nga Maqedonia në demokracinë e re maqedonase bënte thirrje për bashkim. Në një shoqëri demokratike por konservative dhe të mbyllur – të ndarë në aspektin nacional, këto mesazhe ishin risi. Popullariteti i tij politik i detyroi BDI-në dhe PDSH-në të sillen më seriozisht në zgjedhjet presidenciale. Ekzistonte frika nga suksesi i Imer Selmanit që më vonë do mund të përkthehej në sukses partiak të DR-së. Në fund të zgjedhjeve, qasja e tij ndaj qytetarëve është sukses i padyshimtë. Suksesin e rezultateve në zgjedhjet e vitit 2009 nuk ia sollën vetëm votat „shqiptare”. Pa dyshim përqindja e tyre ishte e lartë, por gjerësisht të përfaqësuar ishin dhe votat maqedonase, turke dhe rome.

Në rrethin e parë të zgjedhjeve, më shumë vota fituan kandidatët Fërçkovski dhe Ivanov, ndërsa i treti sipas rezultateve ishte Selmani. I mungonin 55,000 vota për të hyrë në rrethine dytë në vendin e kandidatit nga LSDM-ja. Megjithatë, tek shqiptarët ai korri sukses të rëndësishëm. Ai fitoi shumë më shumë vota (147,500 : 104,000) se shuma e përbashkët e votave për dy kandidatët e tjerë të nominuar nga parti „shqiptare”, Hoxha dhe Buxhaku.

Tabela 1: Rezultatet nga rrethi i parë nga zgjedhjet presidenciale në vitin 2009

Kandidati	Vota në rrethin e parë (%)
Gjorgje Ivanov	345,850 (35,04)
Lubomir Fërçkovski	202,691 (20,54)
Imer Selmani	147,547 (14,95)
Lube Boshkovski	146,878 (14,88)
Agron Buxhaku	73,629 (7,46)
Nano Ruzhin	40,042 (4,06)
Mirushe Hoxha	30,225 (3,06)

Burimi: Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

2.1. GJUHETIA E SUKSESSHME E VOTAVE TË „TË TJERËVE”

Fushata e Selmanit për fitimin e votave të komuniteteve të tjera etnike përveç të atyre „shqiptare” ishte e re dhe e suksesshme. QHKP bëri analizë të votave të Selmanit në rrethin e parë. Llogaritja e votave sipas njësive zgjedhore dhe grupeve etnike është prezantuar në Tabelën 2.

Tabela 2 Llogaritje votave të z. Selmani në zgjedhjet presidenciale të vitit 2009 sipas grupeve etnike

Njësia zgjedhore	Vota maqedonase	Vota turke	Vota rome	Vota boshnjake	Të tjerë	Vota shqiptare	GJITHSEJ Selmani
1	3,690	1,908	1,770	1,905	0	15,029	24,302
2	1,070	683	2,975	436	0	20,915	26,079
3	5,245	1,115	3,595	1,207	0	2,353	13,515
4	6,058	3,600	1,807	58	0	151	11,674
5	2,022	6,765	4,378	988	611	13,595	28,362
6	960	5,220	921	57	76	36,381	43,615
GJITHSEJ	19,045	19,291	15,446	4,651	687	88,424	147,547
%	12,90	13,07	10,46	3,15	0,46	59,92	100

Burimi: Llogaritje e Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

Me metodologjinë e llogaritjes¹², mund të përfundojmë se mesazhi politik ka ndikuar në disponimin votues tek „votuesit jo-shqiptarë” – 40% e votave për Imer Selmanin nuk janë „shqiptarë”.



(Fotografi e huazuar nga www.tv21.mk)

Selmani në mënyrë të suksesshme ka gjuajtur vota nga „të tjerët” gjithandej në Maqedoni. Kemi veçuar gjashtë komuna, gjegjësisht nga secila njësi zgjedhore nga një, ku Selmani ka tërhequr vota në vendbanime ku thuajse nuk jetojnë shqiptarë të Maqedonisë.

Tabela 3 Votat e „të tjerëve” për Selmanin në komuna të caktuara në vitin 2009

Komuna (NjZ)	Votat maqedonase	Votat turke	Votat rome	Votat boshnjake	Votat shqiptare	GJITHSEJ Selmani
Karposh (1)	990	39	147	78	700	1,954
Gazi Bana (2)	213	179	669	101	2,383	3,545
Shtip (3)	899	335	866	18	23	2,141
Prilep (4)	1,307	230	806	33	46	2,422
Manastir (5)	1,065	426	1,624	15	768	3,898
Tetovë (6)	138	672	557	33	5,851	7,251

Burimi: Vlerësim i Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP), 2017

Mund të vërejmë se në Gazi Babë dhe në Tetovë votat maqedonase mungojnë, gjegjësisht janë në numër më të vogël. Në dëm të tyre, në këto komuna mesazhi i Selmanit i përfitoi votat rome, turke dhe boshnjake. Megjithatë, nëse e marrim parasysh Prilepin ose Shtipin ku shqiptarët e Maqedonisë janë në numër shumë të vogël (më pak se 1% sipas regjistrimit të fundit të popullsisë), do të vërejmë se Selmani ka fituar më shumë vota nga votuesit maqedonas.

¹² Duke u bazuar në të dhënat e disponueshme për publikun për rezultatet e zgjedhjeve, për përshkrim të njësive zgjedhore dhe për votuesit sipas vendvotimeve, www.sec.mk, <https://izbirackispisok.gov.mk/Search.aspx?type=address>, <http://www.mojotizbor.mk/arhiva/informacii/izboren-proces/opisi-na-izbiracki-mesta.html>, u krijua bazë e të dhënave me rezultatet nga të gjitha zgjedhjet (lokale, presidenciale, parlamentare) sipas vendvotimeve. Në hapësirat e përziera është bërë vlerësim për përbërjen etnike në ato vendvotime. Janë marrë parasysh rezultatet historike të partive, përkrahjet maksimale të kandidatëve dhe partive të grupeve etnike të caktuara. Njëkohësisht janë marrë parasysh të dhënat për pjesëmarrje në të gjitha ciklet e zgjedhjeve. Si do qoftë, bëhet fjalë për vlerësim të rezultateve pa garantuar saktësi absolute, gjë që as nuk është e mundur duke e pasur parasysh anonimitetin e votës dhe të drejtën e secilit qytetar për vetëvendosje të përkatësisë etnike/nacionale.

2.2. JO SA SELMANI, POR GJITHSISI SUKSES NË ZGJEDHJET LOKALE PËR DEMOKRACINË E RE

Në vitin 2009, së bashku me zgjedhjet presidenciale u mbajtën edhe zgjedhjet lokale ku Demokracia e re u paraqit me kandidatë për kryetarë komunash dhe lista të kandidatëve për anëtarë të këshillit komunal. Suksesi i Selmanit në zgjedhjet presidenciale është shumë më i madh nga ai i partisë në zgjedhjet lokale. Për dallim nga ato presidenciale, në zgjedhjet lokale DR nuk u paraqit me mesazh të ngjashëm si ai i Selmanit, për multikulturë dhe bashkim, por kryesisht u fokusua në çështje dhe tema lokale.

Tabela 4 Rezultati i Imer Selmanit i krahasuar me listat e këshilltarëve të Demokracisë së Re

	Përmbledhje e votave për lista të këshilltarëve	Komuna me më shumë se 50% banorë shqiptarë ¹³	Komuna me banorë shqiptarë nga 17-43% ¹⁴	Komuna me banorë shqiptarë nga 1-9%	Komuna me banorë shqiptarë nën 1%
DUI	97,107	77,507	15,524	4,076	
ND	40,547	27,610	8,643	3,251	
DPA	36,858	31,548	4,014	1,391	
	Zgjedhjet presidenciale	Zgjedhjet presidenciale në këto komuna	Zgjedhjet presidenciale në këto komuna	Zgjedhjet presidenciale në këto komuna	Zgjedhjet presidenciale në këto komuna
Selmani	147,547	81,257	24,964	19,381	22,267
Buxhaku	73,629	58,729	11,398	2,529	1,523
Hoxha	30,225	24,731	2,457	991	2,015

Burimi: Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, QHKP

Dhe përkundër dallimeve të mëdha në krahasim me rezultatet e Selmanit, DR kishte sukses të madh nëse merret parasysh se u themelua vetëm pak para zgjedhjeve lokale dhe i mungonte strukturë partiake që do të udhëhiqte fushatë zgjedhore efektive. Si parti e re, konsiderohet si sukses që në hapësirat kryesisht të banuara me shqiptarë DR ishte shumë pak më e dobët se PDSh. Në këto hapësira rezultati i Selmanit ishte i bindshëm në krahasim me kandidatët e tjerë për president të përkatësisë etnike shqiptare. Ai kishte rejting shumë më të lartë se partia e tij. Është interesant fakti që në hapësirat ku popullata shqiptare është më pak se 1% Imer Selmani kishte rezultat të shkëlqyeshëm në krahasim me kandidatët e tjerë „shqiptarë”. E ngjashme është situata dhe me rezultatet e listave për kryetarë komunash.

13 Haračinë, Bogovinë, Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Dibër, Zhelinë, Zajaz, Likovë, Oslomej, Strugë, Studenica, Tearcë, Tetovë, Saraj, Çair

14 Dolnen, Zelenikovë, Jegunovcë, Kërçovë, Krushevë, Kumanovë, Mavrovë, Petrovec, Sopishtë, Çashkë, Çuçer Sandevë, Butel, Gazi Babë, Shuto Orizarë

Tabela 5 Rezultatet e listave për kryetarë komunash të partive „shqiptare” në vitin 2009

	Përmbledhje	Komuna kryesisht të banuara me shqiptarë	Komuna me popullatë shqiptare nga 17-43%	Komuna me popullatë shqiptare nga 1-9%
BDI	98,922	87,583	10,915	424
DR	37,410	27,803	8,602	1,005
PDSH	37,377	34,385	2,992	
RDK (Rufi Osmani)	15,792			

Burimi: Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

Sërish mund t'i vërejmë dallimet e mëdha në rezultatet e Selmanit nga listat për kryetarë komunash të DR-së. DR ka dalë më mirë dhe nga PDSH-ja, por shumë më dobët se BDI-ja. Ndërsa më e dobët në raport me BDI-në dhe PDSH-në ishte në komunat me popullsi kryesisht „shqiptare”. Në komunat me popullsi „shqiptare” nga 1-9%, DR ishte dyfish më e fuqishme se BDI. Megjithatë duhet të merret parasysh se DR de facto nuk pati fushatë të fuqishme për listën e këshilltarëve komunal në Gostivar sepse e përkrahu Rufi Osmanin për kryetar komune, i cili fitoi me 19.500 vota.

2.3. ÇFARË MUND NDODHTE?

Rezultatet e Imer Selmanit nga zgjedhjet presidenciale mund të ishin themel që do sillnin ndryshime në gjendjen politike në Republikën e Maqedonisë. Me përsëritjen e sukseseve zgjedhore të Selmanit në zgjedhjet parlamentare, Demokracia e re do të mund të ishte faktor i rëndësishëm në formimin e koalicionit qeverisës. Është e rëndë të supozohet si do dukej ky rezultat sikur Selmani të arrinte t'i përcillte sukseset e tij në nivel partiak. Këtu, sipas modelit të D'Hontit, rezultatet e zgjedhjeve presidenciale janë vënë në simulim të zgjedhjeve parlamentare duke i përdorur rezultatet e kandidatëve presidencial (Selmani për Demokracinë e re, Boshkovski për Të bashkuar për Maqedoninë, Ivanov për VMRO-DPMNE, etj.) sikur të ishin rezultate partiake.

Tabela 6 Skenar i rezultateve zgjedhore „presidencialet si parlamentare”

Njësia zgjedhore	1	2	3	4	5	6	Gjithsej deputetë
VMRO DPMNE	7	7	10	10	8	2	44
Të bashkuar për Maqedoninë	3	3	4	3	4	1	18
LSDM	6	4	5	6	4	2	27
BDI	1	2			1	6	10
PDSH						2	2
DR	3	4	1	1	3	5	17
RDK						2	2

Burimi: Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

Nga kjo tabelë mund të vërejmë se me vërtetimin eventual të suksesit të Selmanit në nivel të Demokracisë së re, kjo parti do të ishte dominuese mes partive „shqiptare” dhe do të kishte fuqi të madhe në negociatat për koalicionim gjatë formimit të qeverisë (për shembull, sipas simulimit mundësi për formim të qeverisë kanë VMRO-DPMNE dhe Demokracia e Re me 61 deputetë, LSDM me Të bashkuar për Maqedoninë dhe Demokracia e re me 62 deputetë).

2.4. NGA SUKSESI NË HUMNERË

Asnjë nga skenarët optimist nuk u realizua. Demokracia e re pati rezultate të dobëta në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2011. Atëherë e ndryshoi qasjen e saj ndaj votuesve jo-shqiptarë. Qasja qytetare e Selmanit dhe e DR-së mungoi pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2009. Pas zgjedhjeve presidenciale, u bë e zakonshme për publikun që Demokracia e re të koncentrohet vetëm në tema aktuale të skenës politike për shqiptarët e Maqedonisë. Rrethanat ndryshuan. Selmani dhe partia e tij e ndryshuan strategjinë për temat nacionale. Gjegjësisht, „pas bumit fillestar që e shkaktoi edhe mes votuesve maqedonas, që paraqiste hap të madh përpara, tani politika e tij është reduktuar në përfaqësim të fortë të kauzës kombëtare”.¹⁵ Në vjeshtën e vitit 2009, Demokracia e Re tani më u transformua në promotor vetëm të „çështjeve etnike shqiptare”. Kështu, Demokracia e Re nga Gorgje Ivanov kërkoi që në Këshillin për siguri të ketë së paku dy shqiptarë etnik. Presidenti propozoi vetëm një shqiptar. Më tej, Demokracia e Re kërkoi ndryshim të stemës shtetërore, ndërtimin e xhamisë Burmalit në sheshin e Shkupit, të drejta të barabarta të UÇK-së me ata të „branitellave” të vitit 2001, etj..¹⁶

Në vitin 2011, DR garoi në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në programin zgjedhor propozoi reformë kushtetuese për riafirmimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe për zgjidhje të shpejtë të çështjes së emrit. Selmani potencoi se do të përkushtohen për zyrtarizimin e gjuhës shqipe në vend, për zbatimin e parimit të Badenterit për zgjedhjen e qeverisë, kryetarit të Kuvendit, miratimin e buxhetit dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Slogani i Demokracisë së Re në këto zgjedhje ishte „Bashkohu, ia vlen!”¹⁷



15 Aleksandra M. Mitevka – Utrinski vesnik 21.10.2018: Selmani e zhveshi kostumin e Obamës së Maqedonisë (burimi në internet <http://utrinski.mk/?ItemID=172BF2D9F21603449D6D664C340184FC&commentID=279684&pLikeVote=0>)

16 Aleksandra M. Mitevka – Utrinski vesnik 21.10.2018: Selmani e zhveshi kostumin e Obamës së Maqedonisë (burimi në internet <http://utrinski.mk/?ItemID=172BF2D9F21603449D6D664C340184FC&commentID=279684&pLikeVote=0>)

17 Gazeta Dnevnik, 07.05.2011: Selmani i prezantoi programin dhe kandidatët për deputet (burimi në internet <http://dnevnik.mk/default.asp?ItemID=8AB3DF6790579C44BD81523768615BA1>)

Në zgjedhjet e vitit 2011, DR i fitoi 19.957 vota, por nuk fitoi asnjë mandat deputeti. Për shkak të rezultateve të dobëta në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, Selmani dha dorëheqja nga pozita e kryetarit të DR-së.¹⁸ Rezultatet e DR-së në vitin 2011 ishin larg rezultateve të Selmanit në vitin 2009. Edh pse nuk mund të bëjmë krahasime mes zgjedhjeve parlamentare të vitit 2011 me ato lokale të vitit 2009, sërish do i marrim numrat në njësitë zgjedhore 1, 2, 5 dhe 6 ku DR kishte lista deputetësh dhe do i krahasojmë me rezultatet e listave të këshilltarëve komunal nga viti 2009. Rënia drastike e DR-së në periudhë dy vjeçare është e dukshme.

Tabela 7 Votat për Demokracinë e re në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011

Njësia zgjedhore	Lokale DR 2009	Parlamentare DR 2011
1	9,696	4,337
2	11,425	7,346
5	5,612	4,222
6	10,492	4,053
GJITHSEJ	37,225	19,958

Burimi: Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

Në zgjedhjet parlamentare DR kishte 14.587 vota më pak për dallim nga ato lokale në vitin 2009. Partia e humbi besimin dhe në komuna të banuara kryesisht me shqiptarë etnik si dhe në hapësira me popullatë të përzier etnikisht. Në njësinë e parë zgjedhore në komunat „shqiptare” dështimi ishte i madh në Saraj dhe Çair ku në vitin 2011 janë fituar vetëm 46% dhe 35% respektivisht nga votat e partisë të fituara në vitin 2009. Në komunat „maqedonase” rënia është e madhe në Karposh dhe Aerodrom. Në njësinë e dytë zgjedhore në komunat „shqiptare” dështimi është i madh në Likovë dhe Çair, ku në vitin 2001 janë fituar vetëm 54% e votave të partisë të fituara në vitin 2009, ndërsa në komunat e „përziera” Butel dhe Gazi Babë, janë fituar vetëm 52% dhe 55% e votave të fituara në vitin 2009.

Tabela 8 Vota për DR-në në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011 sipas komunave në njësitë zgjedhore 1 dhe 2

1 Njësia zgjedhore (komuna)	2009	2011	2011:2009 në %	2 Njësia zgjedhore (komuna)	2009	2011	2011:2009 në %
Saraj	3,900	1,809	46	Haračinë	1,736	1,390	80
Aerodrom	352	65	18	Butel	1,396	730	52
Studenica	1,027	630	61	Gazi Babë	1,336	740	55
Sopishtë	152	141	93	Kumanovë	2,248	1,799	80
Kisella Vodë, Makedonski Brod, Qendër (partia nuk ka listë në vitin 2009)	0	160		Gjorçe Petrov, Staro Nagoriçane (partia nuk ka listë në vitin 2009)		102	0
Çair (pjesërisht)	3,619	1,260	35	Çair (pjesërisht)	1,289	791	61
Karposh	646	273	42	Shuto Orizarë	615	293	48
				Likovë	2,805	1,501	54
GJITHSEJ	9,696	4,337	45	GJITHSEJ		7,346	64

Burimi: Llogaritje e QHKP bazuar në të dhënat e KShZ-së në vitet 2009 dhe 2011

¹⁸ Gazeta Utrinski vesnik 07.16.2011: Dhe Selmani dha dorëheqje (burimi në internet <http://utrinski.mk/?ItemID=0A5C0E2E0D9CE8438B986BC6FF2B1A59>)

Më tej, në njësinë e pestë zgjedhore në komunat „maqedonase” dështimi ishte i madh në Manastir, ku në vitin 2011 janë fituar vetëm 47% e votave të partisë në vitin 2009. Rënie ka dhe në komuna të tjera kryesisht „maqedonase” si Kërçova, Resnja, Krusheva, si dhe Dollneni i larmishëm. Vetëm në Strugë si komunë me shumicë „shqiptare” dhe në Ohër si komunë me shumicë „maqedonase” partia ka arritur rezultate solide në raport me zgjedhjet e vitit 2009 (88% dhe respektivisht 103%). Në njësinë zgjedhore gjashtë rënia është dramatike në të gjitha komunat si në Zhelinë dhe Bogovinë (12% dhe 6% nga rezultatet e vitit 2009), por rënia është e madhe dhe në komunat „maqedonase” si Jegunovcë (13%) dhe në komunat kryesisht „shqiptare” me numër të konsiderueshëm të komuniteteve të tjera etnike, si për shembull Tearcë, Vrapçisht ose Tetovë (23%, 30% dhe respektivisht 32%). Rënia e përgjithshme e numrit të votave, me përjashtim të një numri të vogël të komunave kontribuoi në mosfitimin e asnjë mandati të deputetit në Kuvend. Me rezultatet e dobëta të zgjedhjeve të vitit 2011 tregimi për „Obamën e Maqedonisë” mbaroi pa sukses.

Tabela 9 Votat e DR-së në zgjedhjet e viteve 2009 dhe 2011 sipas komunave në njësitë zgjedhore 5 dhe 6

5 Njësia zgjedhore (komuna)	2009	2011	2011 në raport me 2009 në %	6 Njësia zgjedhore (komuna)	2009	2011	2011 në raport me 2009 në %
Manastir	1,049	489	47	Bogovinë	1,656	100	6
Dollnen	618	294	48	Vrapçisht	979	291	30
Kërçovë	189	115	61	Gostivar	886	167	19
Krushevë	357	192	54	Bërvenicë	564	175	31
Ohër	498	514	103	Zhelinë	1,583	183	12
Resnjë	380	198	52	Jegunovcë	295	37	13
Strugë	2,521	2,229	88	Dibër	1,282	2,009	157
Komuna ku në vitin 2009 partia nuk ka lista ¹⁹		191		Komuna ku në vitin 2009 partia nuk ka lista ²⁰		133	
				Tearcë	949	218	23
				Tetovë	2298	741	32
GJITHSEJ	5,612	4,222	74	GJITHSEJ	10,492	4,053	39

Burimi: Llogaritje e QHKP në bazë të të dhënave nga viti 2009 dhe 2011

19 Vevčan, Vraneshticë, Debërc, Demir Hisar, Drugovo, Krivogashtan, Pllasnicë, Centar Zhupa.

20 Mavrovë dhe Rostushë, Oslomej, Zajaz.

3.

STUDIM RASTI: „AKTRIM I PANEVOJSHËM I PATRIOTIZMIT” APO LSDM NË PËRPJEKJE PËR T’I FITUAR VOTAT E „TË TJERËVE”

Në zgjedhjet e vitit 2016, LSDM arriti të përfitojë një numër të konsiderueshëm të votave të shqiptarëve etnik. Këto vota ndihmuan në realizimin e rezultatit shumë më të mirë të LSDM-së në raport me zgjedhjet e humbura në vitet 2011 dhe 2014. „Gjuetia” për votat e shqiptarëve të Maqedonisë është proces afatgjatë. Në vitin 2013 Zoran Zaev kishte intervistë me Muhamed Zeqirin në emisionin „Rruga drejt...” në televizionin Alsat-M ku ai fliste për aktrimin e panevojshëm të patriotizmit nga ana e LSDM-së. Ai potencoi:

„Si parti disa herë jemi përpjekur të luajmë në politikën e patriotizmit. Por ai nuk i përshtatet partisë sonë. Dhe këtu humbëm absolutisht. Është e ndershme ta pranojmë që të kërkojmë shans për të ardhmen, që të mos bëjmë gabime të tilla. Populli nuk pret nga ne të aktrojmë patriotë. Ne jemi parti shtetformues. Ne jemi parti që ka qenë shembull për bashkëjetesë shumë-etnike. Ne jemi parti që e vendosi në këmbë stabile vendin tonë. U munduam të fitojmë pika tek qytetarët duke luajtur me variante patriotike, si për shembull me Ligjin për mbrojtësit, Struga, Kërçova... ajo nuk është për ne social-demokratët, nuk na ngjan. Njerëzit presin që të jemi për kohezion, të jemi faktor bashkimi”.²¹

Që këtu filloi kthesa në politikën e fitimit të votave të shqiptarëve të Maqedonisë nga LSDM. Fushata e parë e LSDM-së në të cilën LSDM u mundua të fitonte votues shqiptarë nga Maqedonia ishte në vitin 2014, në zgjedhjet presidenciale.

21 Elizabeta Galevska – Kanal 5 TV07.06.2013: Zaev: LSDM ka gabur që ka luajtur në politikën e patriotizmit (burimi në internet http://kanal5.com.mk/vesti_detail.asp?ID=9319)

3.1. PENDAROVSKI NË VITIN 2014

Kandidati presidencial i LSDM-së Stevo Pendarovski në zgjedhjet e vitit 2014 u përpoq t'i tërheq votuesit „shqiptarë”. Në rrethin e parë ai garonte me Gjorge Ivanov nga VMRO-DPMNE, Zoran Popovski nga GROM dhe Iljaz Halimi nga PDSH. Në prag të rrethit të dytë, Pendarovski i ftoi shqiptarët e Maqedonisë të mos i bojkotojnë zgjedhjet edhe pse në rrethin e dytë ngelën vetëm kandidatë maqedonas. Mbajti dhe ligjëratë në një universitet në Kosovë ku potencoi se qeveria e Maqedonisë dhe Presidenti i nënçmojnë marrëdhëniet me Kosovën, gjë që ai do ta përmirësonte.²² Atje u takua edhe me kryeministrin Hashim Thaçi. Publiku maqedonas këtë lëvizje e konsideronte si „gjueti” për votat shqiptare.²³ Në materialet e tij reklamuese, billborde dhe video, Pendarovski sloganin e tij „Maqedonia meriton president” e përdori në të dyja gjuhët.



(Fotografi e huazuar nga www.sdsm.org.mk)

Strugës, Studeniçanit, Sarajit dhe Haračinës, ai fitoi edhe në të gjitha komunat me shumicë shqiptare. Edhe pse i fitoi një pjesë të votave të shqiptarëve, fitorja e Ivanovit në komunat e banuara me shumicë „shqiptare”, në përgjithësi ishte rezultat i numrit më të madh të votave që i fitoi nga maqedonasit, serbët, turqit, romët, boshnjakët. Nëse shikohen rezultatet në hapësirat ku ka shumicë shqiptare dhe merren parasysh vetëm vendvotimet ku shqiptarët janë dy të tretat e popullsisë ose më shumë, do të kuptojmë se shqiptarët e Maqedonisë në këto vendvotime „shqiptare” „të pastra” ose thajse „të pastra” kanë votuar në numër më të madh për Pendarovskin se sa për Ivanovin (shiko tabelën 10 më poshtë). Përgjithësi janë vendvotimet kryesisht „shqiptare” në Tetovë, Tearcë dhe Bogovinë ku në numër më të madh kanë votuar për Ivanovin. Përparësia e Pendarovskit është në veçanti e dukshme në Kumanovë, Gostivar dhe Strugë.

Në rrethin e parë shqiptarët e Maqedonisë që kanë dalë në votime bindshëm e kanë votuar Halimin, ndërsa atje ku kanë votuar në rrethin e dytë e kanë preferuar Pen-

Në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale u mbajtën zgjedhjet parlamentare. Kështu, votuesve me prejardhje etnike shqiptare të cilët dolën të votojnë për zgjedhjet parlamentare u është dhënë mundësia të votojnë edhe për zgjedhjet presidenciale dhe të zgjedhin mes Ivanovit dhe Pendarovskit. Ivanov arriti fitore të bindshme në të gjithë vendin, duke fituar me 534,910 vota kundër 398,077 votave të Pendarovskit. Ivanov fitoi thajse në të gjitha komunat e vendit. Përveç

22 Kanal 5, „Pendarovski nga Prishtina me ofendime për Maqedoninë” burimi në internet: http://kanal5.com.mk/mobile/vesti_detail.asp?ID=37669.

23 Gazeta Veçer 24.04.2014: Pendarovski për „puthje dore” në Kosovë – Zaev e luste Thaçin, Stevo Hashimin. Burimi në internet <http://vecer.mk/makedonija/pendarovski-na-baci-raka-vo-kosovo-zaev-go-moleshe-tachi-stevo-hashim>

darovskin në krahasim me Ivanovin.²⁴Këto zgjedhje janë paralajmërim për gjendjen nga viti 2016 kur shqiptarët e Maqedonisë në shumë hapësira kanë votuar për „partinë maqedonase”, LSDM edhe pse kishin zgjedhje nga disa parti të cilat avokojnë për interesat e komunitetit të tyre. Është karakteristike që kandidat i VMRO-DPMNE-së në zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 ka fituar vota nga shqiptarët etnik, diçka që mungoi në vitin 2016. Kjo mungesë me siguri vjen për shkak se VMRO-DPMNE në vitin 2016 aspak nuk ka kërkuar përkrahje nga shqiptarët e Maqedonisë dhe e ka kritikuar fortë fushatën e LSDM-së në pjesën ku Zaev i premtonte këtij komuniteti ndryshime që do e ndryshonin statusin e tyre.

Për shqiptarët e Maqedonisë të cilët dolën në zgjedhje dhe nuk u pëlqeu oferta e BDI-së, PDSH-së, Aleancës së shqiptarëve, Besës dhe PPD-së, si dhe ofertat e partive më të vogla „maqedonase”, zgjidhja mes LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së ishte e lehtë dhe në dobi të social-demokratëve. Rezultatet e Pendarovskit në hapësirat shqiptare ishin pikënisje e mirë për paraqitjen e LSDM-së në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016. Kuptohet, dinamika e zgjedhjeve parlamentare është më ndryshe nga votimi në zgjedhjet presidenciale në rrethin e dytë ky garojnë/garuan dy kandidatë maqedonas. Derisa në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale VMRO-DPMNE dhe LSDM kishin relativisht detyrë të lehtë që t'i motivojnë shqiptarët etnik të dalin të votojnë për „parti maqedonase” në vend se të votojnë për ndonjë nga partitë e shqiptarëve të Maqedonisë. Në vitin 2016 LSDM korri sukses. Nga ana tjetër, „votat shqiptare” për Ivanovin në vitin 2014 u humbën në dy vitet e ardhshme dhe nuk kaluan në llogari të VMRO-DPMNE-së në vitin 2016.

Tabela 10 Votat në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale në vitin 2014 në vende të banuara kryesisht me shqiptarë (vendvotime me më shumë se 2/3 shqiptarë në komuna me më shumë se 10 000 banorë)

Komuna	Gjorge Ivanov	Stevo Pendarovski
Haračinë	376	1,151
Bogovinë	1,661	1,420
Bërvenicë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	1,298	1,490
Gostivar (në vendvotime kryesisht shqiptare)	2,237	4,012
Dibër (në vendvotime kryesisht shqiptare)	692	680
Zhelinë	1,163	856
Jegunovcë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	287	319
Likovë	589	580
Studenican (në vendvotime kryesisht shqiptare)	832	2,285
Çair (në vendvotime kryesisht shqiptare)	1,601 (1,211+390)	3,136 (2,306+830)
Kërçovë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	150	189
Kumanovë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	1,646	3,071
Vrapçisht (në vendvotime kryesisht shqiptare)	893	1,490
Tearcë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	1,505	1,098

24 BDI i bojkotoi zgjedhjet presidenciale meqë VMRO-DPMNE e refuzoi idenë për zgjedhje të „kandidatit konsensual”. Prandaj, në raport me zgjedhjet presidenciale të vitit 2009 në rrethin e parë kishte numër dukshëm më të vogël të votave për kandidatin shqiptar etnik. Nëse në vitin 2009 Mirushe Hoxha, Imer Selmani dhe Agron Buxhaku së bashku kishin 251,401 vota, Iljaz Halimi fitoi vetëm 38,965 vota. Edhe të mos i marrim parasysh votat „maqedonase” dhe të „tjetërve” për Selmanin, numri i votave për kandidat shqiptarë nga Maqedonia është 192,278.

Strugë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	921	3,622
Tetovë (në vendvotime kryesisht shqiptare)	4,655	3,974
Saraj (në vendvotime kryesisht shqiptare)	2,345	2,879
GJITHSEJ	22,851	32,252

Burimi: Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

3.2. FUSHATË PËR VOTËN SHQIPTARE PAS ZGJEDHJEVE TË VITIT 2014

Në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në vitin 2014 fitoi VMRO-DPMNE dhe formoi qeveri me BDI-në. LSDM-ja vendosi të mos i njohë rezultatet zgjedhore. Vijuan një sërë aktivitete jashtë institucioneve – protesta, demonstrata dhe marshe rrugore. Nga fundi i vitit 2014, lideri i opozitës Zoran Zaev ka mbajtur takime me kryetarin e Qeverisë, Nikolla Gruevski. Në fillim të vitit 2015, kryetari i Qeverisë njoftoi se bëhet fjalë për grusht shtet. Pastaj, opozita filloi me projektin „E vërteta për Maqedoninë” duke publikuar të ashtuquajturat bomba (audio incizime) me materiale komprometuese për qeverinë dhe indikacione për korrupsion të mundshëm. Në maj të vitit 2015 në Lagjen e trimave në Kumanovë ndodhi një sulm ndaj forcave të sigurisë, nga një grup i armatosur kryesisht i përbërë nga qytetarë kosovarë. Pas aksionit Zaev i vizitoi qytetarët në këtë lagje të cilët janë kryesisht shqiptarë të Maqedonisë. Ai deklaroi që dëmet materiale duhet të kompensohen patjetër, por kjo nuk mund të bëhet me traumat e qytetarëve. Atje u vu re popullariteti i Zaevit mes banorëve lokal shqiptarë.²⁵



(Fotografi e huazuar nga www.sdsd.org.mk)

Më 17 maj të vitit 2015 vijoi tubimi i madh qytetar i përkrahur nga LSDM në të cilin përveç maqedonasve kishte dhe numër të madh të shqiptarëve etnik, brohoritje, flamuj shqiptarë dhe simbole me Shqipërinë e madhe.²⁶ Edhe pse LSDM e inicioi protestën para qeverisë, ajo u karakterizua si protestë qytetare, e organizuar nga Koalicioni „Qytetarët për Maqedoninë” (e

²⁵ Makfaks11.05.2016: Zaevi në ‘Lagjen e trimave’ të Kumanovës (burimi në internet <http://vesti.mk/read/news/5415987/2044894/zaev-vo-kumanovska-diva-naselba>); Republika17.05.2016: Shqipëria e madhe në protestën e LSDM-së (Burimi në internet <http://republika.mk/431711>).

²⁶ Republika 17.05.2016: Shqipëria e madhe në protestën e LSDM-së (burimi në internet: <http://republika.mk/431711>)

cila numëronte 84 organizata joqeveritare dhe 15 parti politike).²⁷ Në thirrjen për protestë më 17 maj 2015 potencohet:

„Kjo qeveri refuzon të vijë në vete, prandaj duhet të largohet dhe ta çlirojë shtetin nga okupimi. Kjo betejë mes qytetarëve dhe zyrtarëve të Gruevskit, kjo betejë është për kthimin e shoqërisë dhe shtetit në duart e qytetarëve të Maqedonisë “. „This ruling Government refuses to become reasonable and thus needs to leave and free the country from being a hostage. This is a fight between the citizens and the group around Gruevski; this is fighting for bringing back the society and the country in the hands of the Macedonian citizens.“

Në Deklaratën e „Qytetarët për Maqedoninë“ u potencuan këto kërkesa: „kërkojmë që urgjentisht të formohet qeveri kalimtare e cila do të sigurojë pastrimin e listës zgjedhore, çlirimin e servisit të RTVM-së nga kontrolli i qeverisë, zgjedhje e një Prokurori publik të pavarur si dhe organizimi i zgjedhjeve plotësisht të lira dhe demokratike të cilat do ta reflektojnë vullnetin politik real të qytetarëve të Maqedonisë“.²⁸



(Fotografi e huazuar nga www.sdsm.org.mk)

Deklarativisht, protesta kishte për qëllim tubimin e të gjithë qytetarëve pa dallim të përkatësisë etnike apo fetare kundër regjimit „diktatorial“, sido



(Fotografi e huazuar nga www.kurir.mk)



(Fotografi nga www.libertas.mk)

që të bëhet hapi i parë drejt ndërtimit të shtetit qytetar. Në këtë protestë morën pjesë dhjetëra mijëra qytetarë, ose sipas organizatorëve mbi njëqind mijë. Pjesa më e madhe ishin maqedonas, por kishe dhe nga grupet tjera etnike, përfshirë edhe shqiptarë të Maqedonisë.²⁹ Protesta nuk përmbante ikonografi partiake dhe mes demonstruesve kishte flamuj të të gjitha popujve që jetojnë në Maqedoni. Në fjalimin e tij para demonstruesve Zoran Zev deklaroi: „Njëzet e katër vite Maqedonia është një shtet i ndarë në dy shoqëri. Tani e tutje do të jetë një shoqëri krenare për

27 Buletini i Qendrës për demokraci dhe zhvillim, nr. 1, korrik 2015, fq. 1.

28 Shiko „Një vit nga protesta me masovike qytetare kunder-qeveritare e „Qytetarët për Maqedoninë“ këtu: <http://slobodna.mk/2016/05/17/17maj/>

29 Buletin i Qendrës për demokraci dhe zhvillim, nr 1, korrik 2015, fq 2.

shtetin e vet. Dallimet janë pasuria jonë”.³⁰ Megjithatë, duhet të potencohet se edhe pse shqiptarët e Maqedonisë morën pjesë si qytetarë, protesta nuk u përkrah nga asnjë subjekt politik shqiptar, as nga qeveria e as nga opozita. Lëvizja Besa bëri thirrje publike që të mos merret pjesë në këtë protestë për shkak të mosshpjegimit të „së vërtetës” për rastin „Monstra”, zbulimin e aferave korruptive vetëm të partisë maqedonase në qeveri por jo dhe ato të partisë shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI).³¹ Në fakt, për shkak të arsyeve të parashtuara në atë moment ekzistonte skepticizëm i madh mes shqiptarëve të Maqedonisë se Zaev është më shumë i interesuar për ta rrëzuar Gruevskin nga qeveria, se sa ta përmirësojë statusin e shqiptarëve”.³²

Në maj të vitit 2015 Zoran Zaev pati paraqitje publike për tërheqjen e votave shqiptare. Në një televizion kosovar foli për zgjedhjet e humbura në vitin 2006 si dënim nga ana e qytetarëve dhe më pas komentoi për ndikimin pozitiv të njohjes së gjuhës shqipe. „Në kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme... pse vajza ime, për shembull, të mësojë turqisht? Do të mësojë shqip? Që ta përdor, ne jemi bashkë në këtë shoqëri. Përfshirje në aktivitetet të përditshme jo vetëm në administratën publike. Të gjithë duhet të kenë mundësi të drejtë dhe të barabartë në të ardhmen.” Zaev foli edhe për Marrëveshjen e Ohrit: „Tani është koha dhe jemi të gatshëm të jemi të barabartë dhe të flasim për qëllime të përbashkëta, sepse kjo do të përmbushet si kërkesë politike e komunitetit shqiptar. Kam frikë se shumë qytetarë ende flasin për Marrëveshjen kornizë të Ohrit, ne duhet të flasim për problemet tona të përbashkëta, të shkojmë përtej Marrëveshjes së Ohrit”. Ai plotësoi se qeveritë paraprake i janë qasur pa sinqeritet problemit dhe zbatimit të kësaj marrëveshje, për dallim nga partia e tij.³³

Në procesin e arritjes së zgjedhjes për krizën u përfshi edhe komuniteti ndërkombëtar. Në vitin 2015 u nënshkrua e ashtuquajtura „Marrëveshja e Përzghinos”. Marrëveshja parashihte krijimin e qeverisë teknike e cila do të organizojë zgjedhje të reja. Vlen të përmendet se në pjesën e parë të vitit 2016, pjesëmarrësit e të ashtuquajturit „Revolucioni laraman” të cilët për shkak të qëndrimeve kundër qeverisë së VMRO-DPMNE-së me siguri janë votues të LSDM-së ose së paku ishin në zgjedhjet e vitit 2016, në hedhjen e ngjyrave mbi përmendoret dhe institucionet në qendër të Shkupit, nuk i përdhosën ato që paraqesin histori shqiptare.



(Fotografi e huazuar nga www.infomax.mk)

Në gusht të vitit 2016 në arenën Filipi i Dytë u zhvillua ndeshja Shkëndija – Gent. Në tribunë morri pjesë dhe kryetari i LSDM-së Zoran Zaev. Ai e mbështeti Shkëndinë edhe pse tifozët e klubit (të ashtuquajtur Ballistë) bënë tifo me shalle të Shqipërisë së madhe, flamuj të UÇK-së si dhe me fotografi të Xhemë Hasës.³⁴

30 E njëjta.

31 E njëjta.

32 Bulletin i Qendrës për demokraci dhe zhvillim . 1, korrik 2015, fq. 3.

33 Mkd.mk 22.05.2015: Zaev në një televizion kosovar premtori gjuhë shqipe në kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme (burimi në internet: <http://www.mkd.mk/makedonija/partii/zaev-na-kosovska-televizija-vetuva-zadolzhitelen-albanski-jazik-vo-gradinkite>)

34 Telegraf.mk 26.08.2016: Zaevi u shoqërua me „Ballistët”: Lideri i LSDM-së bëri tifo për Shkëndinë përkrah flamujve të UÇK-së (Burimi në internet: <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-zaev-se-zdruzi-so-balistite-liderot-na-sdsm-pokraj-znamina-na-uck-navivase-zaskendija-foto.nspj>)



(Fotografi nga www.telegraf.mk)

LSDM-ja dhe Zoran Zaev në vitet 2015 dhe 2016 u munduan të paraqiten si parti e cila lufton kundër regjimit autoritar në emër të gjithë qytetarëve. Megjithatë, në raport me shqiptarët e Maqedonisë u aplikua një strategji e veçantë për t'i bindur. Duke pasur parasysh se ekzistojnë një sërë partish politike të shqiptarëve të Maqedonisë të cilat kanë platformat e tyre të fokusuara në të drejtat e këtij komuniteti, LSDM dhe lideri Zaev u shfaqën me mesazhe dhe premtime konkrete që do të ishin të pranueshme për këtë popullatë. Mesazhet dhe paraqitjet e tyre ishin risi dhe në njëfarë mënyre paralajmëronin ofertë më të mirë nga LSDM-ja se sa ato që i ofronin subjektet politike të shqiptarëve të Maqedonisë.

3.3. FUSHATA PARAZGJEDHORE NË VITIN 2016

Në këto zgjedhje LSDM u paraqit me fushatën „Plan për jetë në Maqedoni”. Premtimet e përgjithshme të cilat i dha Zaev kishin të bëjnë me paga më të mëdha, demokratizim, punë të denjë dhe drejtësi për të gjithë. LSDM realizoi fushatë të veçantë për tërheqjen e votuesve „shqiptarë” si vazhdim i aktiviteteve të tyre paraprake.



(Fotografi nga www.sdsm.org.mk)

në gjuhën shqipe me autoritetet e vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht të mund të dorëzojnë kërkesa të ndryshme në komunë në gjuhën shqipe.³⁵Në periudhën e njëjtë

35 Press24.mk 14.09.2016: Zaev: Edhe Prilepin do ta bëj dygjuhësh (burimi në internet <http://press24.mk/zaev-i-prilep-kje-go-napравam-dvojazichen-video>)

vazhdoi hapja e temës së dygjuhësisë në opinion. Në një intervistë për NOVA TV, Zaev e dha mendimin e tij për gjuhën shqipe. „Fola për përdorimin e gjuhës shqipe, unë nuk humb asnjë gjë si qytetar i Strumicës ku jemi 94% maqedonas. Domethënë, një gjë duhet të dihet. Praktikën e mira duhet të ndiqen në Maqedoni. Nuk humbas unë asnjë gjë si maqedonas, as qytetari i Shtipit dhe Shkupit me përkatësi etnike maqedonase. Tani është koha të definohet çfarë vendi do të ndërtojme në të ardhmen. Do të jetojmë në tabu?“, tha Zaev.³⁶

Në vitin 2016 LSDM organizonte takime parazgjedhore në vende me banorë kryesisht „shqiptarë“, si për shembull Haračinë dhe Studenican. LSDM-së iu bashkua edhe gazetari Muhamed Zeqiri. Ai u bë pjesë e bordit qendror dhe ekzekutiv të partisë.³⁷



(Fotografi e huazuar nga www.zurnal.net)

Lojtar i rëndësishëm në LSDM është edhe Edmond Ademi, pjesë e udhëheqësisë qendrore. Ademi ka thënë se në LSDM ka 10.000 anëtarë shqiptarë. Sipas tij, nga aktivitetet në terren pritet që numri i votave shqiptare për LSDM-në të jetë mbi 50.000. Mesazhi i LSDM-së është i qartë dhe shqiptarët e Maqedonisë janë të gatshëm t'i përkrahin dhe e kanë besimin e votuesit shqiptar.³⁸ „Besoj në votat shqiptare për LSDM-në, për një koalicion të udhëhequr nga LSDM pa marrë parasysh nëse do të koalicionojmë me parti shqiptare apo jo. Besoj në votat e shqiptarëve në këto zgjedhje dhe pres që LSDM do të fitojë më shumë vota shqiptare nga cila do parti në bllokun shqiptar, sepse i kemi të gjitha arsyet në botë që një gjë e tillë të ndodh“, ka deklaruar Zaev. Duke u përpjekur që t'i tërheq votat „shqiptare“, LSDM vendosi dy shqiptarë nga Maqedonia në „pozita të sigurt“ të listave të kandidatëve. Gazetari Zeqiri në njësinë zgjedhore 2 dhe profesoresha Gjylmsere Kasapi në njësinë zgjedhore 6.³⁹

Gjatë një emisioni në TV21, Zaev foli për atë se nuk ka frikë nëse e humb përkrahjen e votuesve maqedonas. Sipas tij përdorimi i gjuhës mund të jetë përparësi për ne dhe jo dobësi. Ndoshta do të humb vota maqedonase me këtë politikë por ai thotë se nuk është me rëndësi, do të vijin zgjedhje dhe politikanë të rinj. Tani paska qenë koha që të hapen këto tema. Rreth ndryshimit të Kushtetutës ai deklaroi: „Ne shkojmë me koncept qytetarë. Në kohën e përshtatshme, kur të vjen nevoja pragmatike për atë punë, ajo do të ndodh“⁴⁰

36 Netpress.mk 14.09.2016: Zaevi do të gjuajë vota shqiptare me dygjuhësinë (burimi në internet: <http://netpress.com.mk/zaev-dvojazicnost-ke-lovi-albanski-glasovi-video/>)

37 Televizioni 24 Vesti 01.09.2016: Muhamed Zeqiri pjesë e BQ dhe BE të LSDM-së (burimi në internet: <http://24vesti.mk/muhamed-zekiri-chlen-na-co-i-io-na-sdsm>).

38 Sefer Tahiri – Prizma.mk 10.11.2016: LSDM shpreson për 50 mijë vota shqiptare (burimi në internet: <http://prizma.mk/sdsm-se-nadeva-na-50-iljadi-albanski-glasovi/>)

39 Sefer Tahiri – Prizma.mk 10.11.2016: LSDM shpreson për 50 mijë vota shqiptare (burimi në internet: <http://prizma.mk/sdsm-se-nadeva-na-50-iljadi-albanski-glasovi/>)

40 Kurir.mk 10.11.2016: Zaevi paralajmëroi ndryshim të Kushtetutës që t'i përmbush kërkesat e shqiptarëve për dygjuhësi (burimi në internet: <http://kurir.mk/makedonija/vesti/zaev-najavi-promena-na-ustavot-za-da-gi-ispolni-baranata-na-albantsite-za-dvojazicnost-video/>)

Si metodë për tërheqjen e votave shqiptare Zoran Zaev realizoi më shumë takime edhe me përfaqësues të diasporës shqiptare. Është takuar edhe me Musa Lamallarin, kyetar i diasporës shqiptare nga Maqedonia. Lamallari e përkrah ridefinimin/federalizimin e Maqedonisë sipas shembullit të Belgjikës ose Zvicrës. Ai ka qenë



(Fotografi e huazuar nga www.vecер.mk)

i sigurt se Zaev do të fitojë shumë vota „shqiptare” në të gjitha njësitë zgjedhore ku ka shqiptarë të Maqedonisë dhe se ai do të bëhet kryeministër.⁴¹

Idetë e veta për dygjuhësi dhe përfitimin e votuesve „shqiptarë” LSDM-ja i promovoi edhe në diasporë. Gjatë vizitës në Zvicër, në debatin në temë „Maqedonia në prag të zgjedhjeve: Ndryshimet, ilu-

zion apo realitet” në Bern u takua me shqiptarë të Maqedonisë. Atëherë Zaevi e akuzoi qeverinë për marrëdhëniet e këqija me fqinjët. „Nëse jeni të hidhëruar me Maqedoninë, problemi qëndron tek Maqedonia”. Ai foli haptazi për përdorim më të madh të gjuhëve. „Unë jam Zoran Zaevi i njëjtë që e hapi haptazi temën për përdorimin e gjuhëve në Maqedoni dhe për barazinë në vend. Jam i njëjti që e keni parë në Fejsbuk dhe televizor duke hapur shtabe në Haraçinë dhe Çegran. Maqedoninë e paramendoj të tillë që nëse dimë kinezisht, të kuptohemi në kinezisht, nëse dimë anglisht, anglisht të merremi vesh, frëngjisht-frëngjisht, shqip-shqip, maqedonisht-maqedonisht, të çlirohemi” – ka thënë Zaev.⁴²

Në fjalimin e tij, Zaev është ndalur edhe tek Marrëveshja kornizë e Ohrit. „Marrëveshja kornizë e Ohrit nuk është marrëveshje. Duhet të udhëhiqemi me Marrëveshjen kornizë të Ohrit me që shërben si një lloj kornize. Pse në shekullin 21, 25 vite Maqedoni e pavarur, të ketë kufizime? Jo, do të besojmë në barazi dhe do i ndihmoj bashkëqytetarit tim shqiptar” ka thënë Zaev.⁴³ Përveç se hapi shtabe në hapësirat „shqiptare” si në Haraçinë, LSDM shtabin e vet në Çair e shënoi me tabelë dygjuhësore.



(Fotografi e huazuar nga www.b2.mk)

41 L.Z. – Gazeta Vecer 28.11.2016: Musa Lamallari: Zaev është profet i shqiptarëve. (<http://vecер.mk/makedonija/musa-ljamalari-zaev-e-mesija-na-albancite>)

42 Telegraf.mk 17.11.2016: Problemi i tij është Maqedonia: Deklarata skandaloze të Zaevit në Zvicër, godet kushtetutshmërinë (<http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-makedonija-mu-e-problemot-skandalozni-izjavi-na-zaev-vo-svajcarija-udri-po-ustavnota-video.nspх>)

43 Telegraf.mk 17.11.2016: Problemi i tij është Maqedonia: Deklarata skandaloze të Zaevit në Zvicër, godet kushtetutshmërinë (<http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-makedonija-mu-e-problemot-skandalozni-izjavi-na-zaev-vo-svajcarija-udri-po-ustavnota-video.nspх>)

LSDM-ja vazhdoi me përkushtimin e saj për tërheqjen e votave „shqiptare” kështu që edhe deklaratat për medime i dërgonin në gjuhën shqipe dhe maqedonase.⁴⁴ Gjithashtu, në komuna ku shqiptarët e Maqedonisë nuk janë shumicë, dukeshin edhe flamuj shqiptarë në tubime partiake.⁴⁵ Nga tubimet në hapësirat „shqiptare” më e dalluar ishte paraqitja e Zoran Zaevit në Haračinë. „Unë jam njeri i juaji, mbështetuni tek unë”, ishte mesazhi të cilin e dha lideri i LSDM-së. „E di se jam maqedonasi i parë për të cilin shqiptarët japin përkrahje të sinqertë dhe kjo më jep obligim serioz të jap fjalën këtu para jush se jam njeri i juaji. Mbështetuni në mua për gjithçka që duhet, më llogaritni për njeri tuajin... Jo vetëm maqedonasit, edhe shqiptarët do të kenë kryeministrin e tyre dhe emri i tij është Zoran Zaev”, tha Zaev në Haračinë.⁴⁶

Kandidatët shqiptarë në listat e LSDM-së ndikuan gjatë fushatës mbi votuesit e këtij nacionaliteti. Gjylymsere Kasapi e cila gjendet në listën e kandidatëve për deputetë të LSDM-së në vend të dytë në njësinë zgjedhore 6, menjëherë pas bartësit Petre Shilegov, gjatë një emisioni në televizionin Alsat-M konfirmoi se lideri i partisë Zoran Zaev në programin e tij parasheh futjen e gjuhës shqipe në Maqedoni në nivel më të lartë se aktualisht. „Platformën të cilën dhe unë e përkrah, si dhe parimet që janë vendosur fuqishëm në platformën parazgjedhore më bindin se LSDM e udhëhequr nga Zoran Zaev do ta realizojë dhe do ta largojë nga rendi i ditës përdorimin e gjuhës shqipe në Maqedoni”. Për këtë sigurisht se po përgatitet program special i cili gjithsesi do të miratohet në instancat më të larta shtetërore”, tha Kasapi.⁴⁷ Kandidatja për deputete na bind se programi parazgjedhor i LSDM-së mundëson të zgjidhen shumë çështje të shqiptarëve përfshirë edhe çështjen e gjuhës. „E kam lexuar dhe e kam studiuar shumë mirë programin e LSDM-së dhe definitivisht besoj se shumë probleme do të zgjidhen përfshirë edhe problemi me gjuhën shqipe”, potencoi Kasapi. Ajo beson se partitë shqiptare nuk kanë arritur t’i zgjidhin problemet e shqiptarëve të Maqedonisë. Duke i’u dhënë shpresë se LSDM mund ta realizojë atë, ajo shton se „Kam përshtypjen se partitë shqiptare duke u grindur njëra me tjetrën nuk arrijnë t’i zgjidhin çështjet vitale dhe kryesore.”⁴⁸

Në kapitullin e pestë të „Planit për Maqedoninë” i titulluar „Ndërtojmë një shoqëri” ka disa plane dhe qëllime të cilat mund të interpretohen në kontekst të fushatës për „gjuajtjen” e votave „shqiptare”. „LSDM dëshiron t’i japë fund ndarjes etnike. Do të përkrahim politikë gjuhësore në pajtim me nevojat dhe interesat e individëve dhe shoqërisë”.⁴⁹ Në faqen 188, në kapitullin e pestë, paralajmërohet paraqitja e elementeve të të ashtuquajturit arsim multikulturor. Vendi primar ku duhet të ndërtohen vlerat e një shoqërie të përbashkët janë kopshtet e fëmijëve. Prandaj, do të aplikojmë elementë të njoftimit multikulturor për të gjithë fëmijët që në moshën më të hershme, përmes projekteve dhe aktiviteteve që zhvillojnë ndjenjën e lirisë,

44 Ivana Stojanovska – Televizioni Kanal 5 09.11.2016: Shtab dygjuhësor i LSDM-së në Çair (burimi në internet http://kanal5.com.mk/vesti_detail.asp?ID=108120)

45 Gazeta Veçer 27.11.2016: Në tubimin e LSDM-së më shumë flamuj shqiptarë se maqedonas (burimi në internet: <http://vecer.mk/makedonija/na-mitingot-na-sdsm-povekje-albanski-od-makedonski-znaminja>)

46 Vesna Kuksanova Krstevska – Televizioni Alfa 09.12.2016: Zaev nga Araçina – Unë jam njeri i juaji, llogaritni në mua (burimi në internet <http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=116151#.WVJNY5LfodX>)

47 Republika.mk 21.11.2016: Gjylymsere Kasapi nga NjZ 6 e konfirmoi: Do të votojë si shqiptare për LSDM-në, Zaev do e ridefinojë shtetin (burimi në internet <http://republika.mk/689239>)

48 Republika.mk 21.11.2016: Gjylymsere Kasapi nga njësia 6 konfirmoi: Do të votojë si shqiptare për LSDM-në, Zaev do ta ridefinojë shtetin. (burimi në internet: <http://republika.mk/689239>)

49 Plan për jetë në Maqedoni – faqja 188.

tolerancës dhe bashkëjetesës. Do të përdoren praktikat nga projektet e suksesshme për këtë nivel të arsimit. Do të stimulohen projekte të shoqërimit multikulturor dhe komunikimit ndër-gjuhësor edhe në nivelet më të larta të arsimit”. Siç e përmendëm, në intervistën në televizionin kosovar Jeta në Kosovë, Zaev flet për futjen e gjuhës shqipe në kopshte.⁵⁰

Në pjesën „Mbrotja e gjuhëve të komuniteteve të tjera dhe komunikimi ndërkulturore” LSDM paralajmëron: „do të krijojmë zgjidhje të cilat në mënyrë proporcionale do t’i mbrojnë dhe do t’i avancojnë gjuhët dhe traditat e tjera, dhe u japim përkrahje projekteve ndërkulturore dhe praktikave ndër-gjuhësore”.⁵¹ Decentralizimi i qeverisjes po bëhet prioritet kryesor në program. Në faqen 163 në pjesën „Përforsimi i vetëqeverisjes lokale” flitet për kompetencat e transferuara drejt vetëqeverisjeve lokale. Sipas ndryshimeve të planifikuara, komunave do t’u transferohen një pjesë e funksioneve drejtuese të MPB-së, policia, ndihma e shpejtë medicinale, mbrotja sociale, qendrat për punësim, decentralizim i institucioneve në fushën e kulturës etj.. Në program flitet për komuna politipe si mënyrë e decentralizimit. „Do të krijojmë komuna politipe me kompetenca të ndryshme, varësisht nga madhësia dhe kapacitetet e ndërtuara si dhe fuqia për të siguruar të ardhura vetanake, ose me ndarjen e kompetencave në ato të obligueshme dhe zgjedhore”.⁵² Kjo është pjesë e masave të paraqitura në program. Komentet negative në fushatën e VMRO-DPMNE-së për këto masa arritën të ndikojnë në mendimin e së paku një pjesë të opinionit se LSDM po përgatit kantonizim ose federalizim me përforsimin e vetëqeverisjeve lokale, gjegjësisht përforsimin e decentralizimit.

Më 11 dhjetor të vitit 2016 u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Fushata politike e LSDM-së drejt votuesve „shqiptar” ishte e suksesshme. LSDM shkoi një hap më përpara nga qasja qytetare e Selmanit. Në vend se qasje qytetare ndaj votuesve „shqiptar”, zhvillohej fushatë për përfaqësimin e interesave të tyre në Maqedoni. Prandaj, LSDM arriti të tërheq përkrahje të konsiderueshme edhe në komuna të banuara kryesisht me „shqiptar”, të dalë me rezultate më të mira se „partitë e bllokut shqiptar”. QHKP bëri analizë të votave „shqiptare” për LSDM-në në zgjedhjet e vitit 2016.

Tabela 11 Llogaritja e votave „shqiptare” për LSDM-në

Njësia zgjedhore	Gjithsej vota	Vota shqiptare	% e votave shqiptare nga ato të LSDM-së
1	92,247	7,758	8.4%
2	69,842	12,531	17.9%
3	81,204	2,046	2.5%
4	94,780	40	0.04%
5	71,020	4,497	6.3%
6	25,986	11,290	43.4%
Përmbledhje e votave për LSDM-në	435,079	38,162	8.8%

Burimi: Llogaritje e Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

⁵⁰ E njëjta.

⁵¹ Plan për jetë në Maqedoni – faqja 188.

⁵² Plan për jetë në Maqedoni – faqja 163.

Në përqindje, LSDM-ja një pjesë shumë të madhe të votave të veta i fitoi nga votuesit shqiptar nga Maqedonia në njësitë zgjedhore 2 dhe 6. Në njësitë zgjedhore 1 dhe 5 përkrahja e shqiptarëve të Maqedonisë për LSDM-në ishte më e vogël por duhet të merret parasysh se atje, në përgjithësi, numri i votuesve etnik shqiptar është më i vogël se në njësitë zgjedhore 2 dhe 6. Në njësitë zgjedhore 3 dhe 4 numri i shqiptarëve të Maqedonisë është shumë i vogël dhe mbështetja e tyre për LSDM-në është më e vogël në raport me njësitë e tjera zgjedhore si në përqindje ashtu edhe në numra absolut.

Tabela 12 Votat për partitë „shqiptare” dhe krahasimi me votat shqiptare për LSDM-në

Njësia zgjedhore	Rangimi i LSDM-së në njësinë zgjedhore	Vota shqiptare për LSDM-në	% e votave shqiptare për LSDM-në nga votat totale	BDI	BESA	PDSH	Aleanca për Shqiptarët	Gjithsej
1	3	7,758	19	12,890	11,597	4,851	3,769	40,865
2	3	12,531	22	16,868	16,119	5,938	6,051	57,507
3	1	2,046	54	1,142			587	3775
4	2	40	8	481				521
5	4	4,497	13	13,982	5,163	3,426	7,355	34,423
6	5	11,290	10	40,547	24,989	16,162	17,946	110,934
Përmbledhje ⁵³	3	38,162	15	86,796	57,868	30,964	35,121	248,911

Burimi: Llogaritje e Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave (QHQP) 2017.

Në nivel të gjithë Maqedonisë mes partive „shqiptare”, LSDM-ja radhitet e treta sipas numrit të votave të shqiptarëve të Maqedonisë. Në njësinë e parë dhe të dytë zgjedhore gjithashtu është e treta sipas fuqisë, ndërsa në njësinë e tretë dhe të katërt është e para dhe e dyta. Sidoqoftë, duhet të potencohet se në dy të fundit numri i votuesve shqiptarë nga Maqedonia është shumë i vogël. Në njësinë e pestë zgjedhore LSDM-ja është e katërta ndërsa në njësinë e gjashtë zgjedhore është e pesta sipas numrit të votave nga shqiptarët e Maqedonisë. Nëse nuk i marrim parasysh njësitë zgjedhore tre dhe katër si përqindje nga votat e përgjithshme të partive „shqiptare”, votat për LSDM-në janë më të shumta në njësinë e parë (19%) dhe të dytë (22%). Atje përkrahja dhe fushata për fitimin e votave të shqiptarëve të Maqedonisë ishte më e madhe. Në zgjedhjet e ardhshme, LSDM përveç se do të duhet ta mbajë mbështetjen që gëzon, do të duhet të punojë më shumë edhe drejt nxitjes së shqiptarëve të Maqedonisë në njësitë zgjedhore pesë dhe gjashtë.

Rezultatet nga zgjedhjet parlamentare e ndryshuan gjendjen politike në Republikën e Maqedonisë. Gjegjësisht, 38,162 vota shqiptare nga 435,079 që i fitoi LSDM duken pak. Por, këto 8.8% nga numri total i votave ishin faktor i rëndësishëm për fitimin e mandateve për deputetë gjatë formimit të qeverisë së re. Është e rëndë të supozohet çfarë rezultati do të sillnin këto zgjidhje nëse një pjesë e votuesve nuk do të votonin jashtë bashkësisë „së tyre” etnike. Këto vota janë bazë e mirë për sukses të ardhshëm në zgjedhjet lokale në hapësirat „e përziera” si dhe në ato „kryesisht” shqiptare.

Sipas modelit të D’Hontit, këto vota të LSDM-së janë kyçe për fitimin e mandateve

⁵³ Partia PPD ka 1,143 vota në gjithë territorin e shtetit.

në disa njësi zgjedhore. Çfarë sikur të mos ishin ato? Vlerësimi është se votat të cilat në vitin 2016 LSDM i tërhoqi nga shqiptarët etnik, në të gjitha zgjedhjet e mëparshme ato do të ishin shpërndarë mes partive „shqiptare” në Maqedoni si BDI, PDSH dhe të tjerët. QHKP bëri simulim të rezultateve të zgjedhjeve. Nëse në njësinë e parë pa votat e shqiptarëve etnik LSDM do të kishte fitore, në njësinë e dytë pa to LSDM do të fitonte një deputet më pak se BESA. Në njësinë e tretë votat e shqiptarëve etnik në dobi të LSDM-së dhe numri më i madh i votave nga komunitetet e tjera më të vogla i sollën LSDM-së një deputet më shumë në dëm të VMRO-DPMNE-në e cila fitoi një deputet më pak. Në njësinë e pestë zgjedhore votat „shqiptare” i sollën LSDM-së një deputet më shumë në dëm të BDI-së, ndërsa në njësinë e gjashtë zgjedhore BESA dhe Aleanca për shqiptarët do të kishin nga një deputet më shumë ndërsa LSDM dhe VMRO-DPMNE nga një më pak. Me aplikimin e modelit të D’Hont, nëse votat „shqiptare” për LSDM-në do të fitoheshin nga partitë „shqiptare”, përfundimisht rezultatet do të dukeshin ndryshe dhe do i hapnin dyert për mundësi të reja për koalicion.

Tabela 13 Projektim i mandateve parlamentare sikur LSDM të mos fitonte vota „shqiptare”

Partia	Mandate sipas KShZ	Mandate sipas simulimit të QHKP
VMRO-DPMNE	51	51
LSDM	49	45
BDI	10	11
BESA	5	7
Aleanca për shqiptarët	3	4
PDSH	2	2
Gjithsej	120	120

Burimi: Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

Nga tabela e paraqitur mund të përfundojmë se votat „shqiptare” për LSDM-në luajnë rol të rëndësishëm, në formimin e koalicioneve. Sipas simulimit të bërë, pa votat „shqiptare” LSDM-ja nuk do të mundej aq lehtë të formonte qeveri. LSDM-ja së bashku me BDI-në dhe Aleancën e shqiptarëve do të kishin 60 deputetë. VMRO-DPMNE së bashku me Besën dhe PDSH-në gjithashtu do të kishin 60 deputetë. Edhe më e rëndësishme është të thuhet se suksesi i „gjuajtjes” së votave „shqiptare” për LSDM-në është bazë për veprime dhe fitore të ardhshme në zgjedhjet lokale në hapësira me popullsi të përzier etnikisht. Si parti qeverisëse, LSDM paralajmëron sjelljen e ligjit të ri për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve jo-shumicë i cili *de facto* do ta avancojë gjuhën shqipe në gjuhë të dytë zyrtare në gjithë territorin e vendit. Duke implementuar politika të projektuara për shqiptarët, LSDM-ja krijon bazë për rritjen e mbështetjes në komunat dhe njësitë zgjedhore ku jetojnë shqiptarë të Maqedonisë. Në zgjedhjet lokale, gjatë betejës së kandidatëve për kryetarë komunash, LSDM do të mund të apelojë tek bashkëqytetarët shqiptarë të Maqedonisë të votojnë për kandidatin e tyre në vend se për atë të VMRO-DPMNE-së.

Rezultatet e LSDM-së mes shqiptarëve të Maqedonisë janë të rëndësishme për performancat në zgjedhjet lokale në kuptimin e kandidatëve eventuale për kryetarë komune si dhe në kuptimin e marrëveshjeve të mundshme për përkrahje në rrethin e dytë ku LSDM mund të negociojë me partitë e shqiptarëve etnik për shkëmbim të përkrahjes me vota. Në tabelën e radhës dallojmë disa komuna të banuara kryesisht me shqiptarë në të cilat LSDM ka rezultate të shkëlqyeshme zgjedhore, si për shembull në Haračinë, Gostivar, Strugë, Saraj, Çair, Gazi Babë dhe Tetovë.

Tabela 14 Komuna me numër të konsiderueshëm të votave të shqiptarëve për LSDM-në

Komuna	Partia me më shumë vota	Gjithsej vota për LSDM-në	Votat shqiptare për LSDM-në	Përqindje e votave shqiptare nga gjithë votat e LSDM-së
Saraj	DUI 6,615	2,973	2,304	77.5%
Haračinë	DUI 1,456	2,052	2,032	99%
Çair (njësia zgjedhore 1 dhe 2)	Besa 8,594	8,626	4,153	48%
Vrapçisht	DUI 3,513	1,345	971	72.2%
Likovë	DUI 4,379	773	773	100%
Kërçovë (njësia zgjedhore 5 dhe 6)	DUI 7,620	5,557	1,063	19.1%
Dibër (njësia zgjedhore 5 dhe 6)	DUI 2,075	2,153	866	40.22%
Strugë	Alliance 5,730	8,420	1,328	15.8%
Gostivar	DUI 8,444	8,288	4,359	52.6
Tetovë	DUI 10,769	7,252	2,682	37%

Burimi: Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (QHKP) 2017

4.

OBAMA I MAQEDONISË APO
PLATFORMA E TIRANËS

Sukseset e Imer Selmanit si kandidat presidencial i Demokracisë së re dhe i LSDM-së në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 janë evidente por janë të rritura në mënyrë të ndryshme. Nga njëra anë, Imer Selmani kishte mesazhe për bashkim të të gjithë qytetarëve të komuniteteve të ndryshme etnike në një koncept shumëkulturore, qytetar. Me një fushatë të tillë ai arriti të fitojë simpati dhe vota nga qytetarë të të gjitha grupeve etnike, përfshirë edhe nga maqedonasit. Nga ana tjetër, LSDM dhe Zaevi „shitën” përralla për koncept qytetar me përmbajtje tjetër. Gjegjësisht, koncepti i tyre qytetar ishte fushatë me dy mesazhe, njëra drejtuar maqedonasve dhe grupeve më të vogla etnike për „jetë” në Maqedoni dhe luftë kundër elitës së partizuar dhe korruptuar të VMRO-DPMNE-së, dhe tjetra për shqiptarët e Maqedonisë, e cila përveç premtimeve për jetë më të mirë përfshinte dhe ide për përmirësimin e statusit dhe fuqisë vetëm të përfaqësuesve të këtij komuniteti në sistemin politik. Në fakt, LSDM-ja dhe Zoran Zaev në zgjedhjet e vitit 2016 ofruan ridefinimin e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni, të paraqitura në Marrëveshjen e Ohrit nga viti 2001. Në ofertën e LSDM-së drejt shqiptarëve të Maqedonisë në vitin 2016 tentohet të ndryshohet bilanci i fuqisë dhe të drejtave në dobi të shqiptarëve etnik që u negociua në Ohër.

Cilat ishin rezultatet nga strategjia e LSDM-së? Zgjedhjet parlamentare në vitin 2016 i sollën sukses LSDM-së në „gjuajtjen” e votave „shqiptare”. Duke luajtur në atë terren, LSDM i ngatërroi „llogaritë” e partive të shqiptarëve etnik. Tek ata ndodhi radikalizimi, gjegjësisht „ethnic outbidding”. „Ethnic outbidding” në shkencat politike analizohet si paraqitje ku partitë etnike adoptojnë strategji radikale me qëllim që ta maksimalizojnë përkrahjen e votuesve nga ai grup etnik si luftëtarë të denjë të *kauzës* dhe të dobësohet legjitimiteti, gjegjësisht të delegjitimizohen rivalët politik, përfaqësues të atij komuniteti.⁵⁴Në teorinë për „ethnic outbidding” potencohet se ajo shpie në garë mes ekstremeve, në ofrimin e opsioneve gjithnjë e më ekstreme për politika publike me të cilat arrijmë në situatë të rrezikshme për shkatërrimin e vetë sistemit politik. „Ethnic outbidding” ndodh kur politikanët të cilët garojnë për mbështetjen e një grupi të caktuar etnik paraqesin kërkesa në dobi të atij grupi dhe në dëm të të tjerëve. Ai është proces ku në kornizat e një komuniteti etnik gara politike reduktohet në nivelin e dëshmimit se cila parti është mbrojtëse më e mad-

⁵⁴ Shiko në Gormley-Heenan, C & MacGinty, R (2008) 'Ethnic Outbidding and Party Modernization: Understanding the Democratic Unionist Party's Electoral Success in the Post-Agreement Environment.' *Ethnopolitics* Vol. 7, No. 1, faqe 44.

he e interesave të atij komuniteti.⁵⁵ Cila do politikë ose situatë që shkakton „ethnic outbidding” kontribuon që marrëveshjet ndëretnike të jenë thuajse të pamundura sepse edhe elitat etnike më të matura radikalizohen, ndërsa diskursi politik i ndjek ato procese. „Ethnic outbidding” mund të ketë pasoja serioze në shoqëritë e ndara, deri në konflikt dhe luftë.

Siç thonë Ginter dhe Dajmond „logjika zgjedhore e partive etnike është mobilizimi i bazës me deklarata që polarizojnë duke paraqitur mundësitë që ai komunitet duhet t’i shfrytëzojë, me kërcënime.... Ekskluziviteti etnik i mesazheve të tyre politike dhe efekti polarizues i të njëjtave ndikojnë në mënyrë dezintegruese dhe përçarëse në shoqëri.”⁵⁶ Edhe politikologë të tjerë të shquar si Samuel Huntington mendojnë se partitë etnike janë rrezik ndaj demokratizimit të një vendi. Ai madje thekson se shumë vende nga e ashtuquajtura „bota e tretë” nuk kanë arritur ta mbajnë demokracinë për shkak të ndikimit të fortë të partive etnike.⁵⁷ Një nga ekspertët më të mëdhenj për çështjet dhe konfliktet e pakicave, Ted Gur, shkon deri në pohimin se thuajse të gjitha rastet e luftërave qytetare në vitet e fundit kanë qenë rezultat i ardhjes në qeveri të partive etnike dhe të promovimit të politikës së tyre politike me natyrë përjashtuese.⁵⁸

Ku është „ethnic outbidding” në kontekstin maqedonas? Pas zgjedhjeve të vitit 2016 BDI, Aleanca e shqiptarëve dhe Besa u pajtuan për një agjendë të re politike në Tiranë e cila i tejkalon reformat e pranura nga Ohri në vitin 2001.⁵⁹ E publikuar më 6 janar 2017, e ashtuquajtura „Platforma e Tiranës” kërkon realizimin e qëllimeve „në mandatin e ardhshëm dhe/ose në çdo mandat të ardhshëm” të cilat do ta rrisnin fuqinë e subjekteve politike të shqiptarëve në vend. Synohet drejt, *de facto*, ndryshimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe ridefinimin e Republikës së Maqedonisë në federatë pa njësi territoriale konkrete për momentin, gjë që nuk e përjashton mundësinë të kërkohej ose të arrihet si hap i ardhshëm. Me platformën parashihej avancimi i statusit të shqiptarëve të Maqedonisë, mes tjerash dhe përmes „zbatimit të drejtë të parimit të multietnicitetit në Kushtetutën e RM-së, ku shqiptarët e Maqedonisë konsiderohen si komb shtetformues... arritjes së barazisë së plotë gjuhësore, përdorimit të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe garantimin e aplikimit të saj si e drejtë themelore dhe kushtetuese. Është paraparë që Kushtetuta të potencojë se „gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj janë gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë”, të hapet debat gjithëpërfshirës për flamurin, himnin dhe stemën shtetërore „me qëllim që simbolet shtetërore ta reflektojnë multietnicitetin shoqëror dhe barazinë etnike”. Në kornizat e ideve për arritjen e barazisë ekonomike dhe mirëqenies shoqërore, në veçanti përmes zhvillimit të barabartë rajonal, kërkohej „krijimi i një Ministrie për sisteme politike dhe marrëdhënie ndëretnike, si organ përgjegjës për respektimin e të drejtave të komuniteteve dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në

55 Për shembull tek: Coakley, J. ‘Ethnic Competition and the Logic of Party System Transformation’ European Journal of Political Research 47 (2008): 766–793.

56 Shiko në Gunther, Richard and Diamond, Larry 2001. ‘Types and Functions of Parties’ in Larry Diamond and Richard Gunther (eds), Political Parties and Democracy. Baltimore and London: Johns Hopkins University Press, страна 23-24.


57 Shiko Huntington, Samuel P. 1991. The Third Wave: Democratization in the Late Twentieth Century. Norman OH: University of Oklahoma Press..

58 Shiko Gurr, Ted Robert. 2000. Peoples Versus States: Minorities at Risk in the New Century. Washington, D.C.: United States Institute of Peace Press.

59 <http://puls24.mk/mk/vesti/tiranska-platforma-integralen-tekst>

rajonet e pazhvilluara”, „realizimin e përfaqësimit të drejtë në organet e sigurisë, në ushtri, inteligjencë dhe drejtësi”, „adoptimin e masave afirmative për të siguruar financimin e institucioneve kulturore shqiptare në nivel qendror dhe lokal”, si dhe „aplikimin e përfaqësimit të drejtë në të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore, në shërbimet publike ose ndërmarrjet me aksione publike”. Në marrëdhëniet me jashtë kërkohet përfshirja e „shqiptarëve në grupet e punës për negociata të drejtpërdrejta me Greqinë dhe Bullgarinë”, „bashkëpunim me Kosovën dhe Shqipërinë për menaxhim të integruar të kufijve” si dhe „hapjen e pikave të reja kufitare”. Përkrah kërkesave të tjera në nivel simbolik insistohet edhe në miratimin e „Rezolutës në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ku dënohet gjenocidi mbi kombin shqiptar në Maqedoni në periudhën 1912-1956”.

Pas publikimit të platformës, VMRO-DPMNE nuk arriti të pajtohet për krijim të qeverisë me BDI-në, por këtë e bëri LSDM duke i përfshirë BDI-në dhe Aleancën e Shqiptarëve. Nga ana tjetër, si pasojë e radikalizimit të kërkesave të subjekteve politike të shqiptarëve të Maqedonisë, lindi një lëvizje protestuese e maqedonasve dhe komuniteteve më të vogla etnike. E udhëhequr nga artistë si Boris Damovski, Bogdan Ilievski dhe Igor Durllovski, protestuesit u bashkuan nën logon „Për Maqedoni të përbashkët” me qëllim që të pamundësohet zbatimi i „Platformës së Tiranës” dhe duke i bërë thirrje Kryetarit të shtetit Ivanov që të mos ia jep mandatin LSDM-së për ta zyrtarizuar koalicionin e dakorduar. Protestat tremujore në një farë mënyre kulminuan më 27 prill kur grupet e deputetëve të LSDM-së, BDI-së dhe Aleancës për Shqiptarë jashtë rregullores e zgjodhën Kryetarin e Kuvendit. Një grup demonstruesish hyri në Kuvend dhe e okupoj sallën plenare dhe qendrën për shtyp, ndërsa disa e sulmuan një pjesë të deputetëve të LSDM-së dhe Aleancës për shqiptarët, duke i përfshirë liderët e tyre Zaev dhe Sela. Mungonte shumë pak që të ndodhte më e keqja, viktima dhe eventualisht luftë qytetare.



(Fotografi e huazuar nga www.zurnal.net)

5.

KONSTATIMET DHE SI MË TEJ?

Për fat të keq projekti shumëkulturore i Imer Selmanit për Maqedoninë nuk pati sukses. Shtatë vite më vonë një tjetër ndërhyrje kontribuoi drejt hapjes së temave të cilat në përgjithësi u mbyllën me Marrëveshjen e Ohrit në vitin 2001. Çështjet etnike u kthyen në fuqi të plotë me fushatën e LSDM-së në zgjedhjet e vitit 2016. Nga analiza është e qartë se projekti i LSDM-së për fitimin e votave të shqiptarëve të Maqedonisë përmes ofrimit të politikave publike të cilat do ta rrisin fuqinë e këtij komuniteti kontribuoi drejt suksesit të tyre zgjedhor. Të rrezikuara, partitë e shqiptarëve etnik u bashkuan rreth „Platformës së Tiranës” duke i rritur kërkesat e tyre edhe më shumë. Reagimi i një pjesë të maqedonasve, turqve, serbëve dhe të tjerëve ishte dhe ende është shumë negativ drejt këtyre kërkesave. Që nga Marrëveshja e Ohrit në vitin 2011 kur shumë çështje për marrëdhëniet ndëretnike u definuan, sot Maqedonia sërish gjendet para një sfide të re që t’i bisedojë, gjegjësisht t’i negocijojë postulatet themelore për rregullimin e shtetit. Nacionalizmi si gjind i nxjerrë nga shishja rëndë se shtypet ose zbutet. Janë të nevojshme strategji të reja që do të mund të kontribuojnë drejt maturisë dhe përafrimit të komuniteteve dhe qytetarëve drejt një qëllimi të përbashkët. Kemi nevojë për kompromise drejt çështjeve etnike.

Modeli integruar e mbështet këtë qasje ndaj zgjedhjeve. Në përgjithësi, konflikti mes grupeve etnike është konflikt për kontrollimin dhe pronësimin e shtetit, konflikt rreth asaj se cili grup etnik ka superioritet mbi të tjerët etj. Nuk ekziston formulë e thjeshtë që do e zvogëlonte konfliktin në vendet ku elektorati është i ndarë në baza etnike. Prandaj është e rëndë të binden liderët partiak për zgjidhje me kompromis pa ju dhënë kompensime të caktuara. Prandaj, vëmendja duhet të përqendrohet në caktimin e kornizave të tilla ligjore që do të nxisin sjellje të matur dhe bashkëpunuese të elitave politike etnike. Stimujt e tillë mund të gjenden lehtë në sistemet zgjedhore. Sistemet zgjedhore mund të caktohen në atë mënyrë që do i inkurajonin dhe vendosnin marrëveshjet ndëretnike dhe të ashtuquajturin akomodim ndëretnik (accomodation). Në këtë rast, zgjedhjet do të ofronin përfitime të veçanta për partitë të cilat janë të interesuara në bashkëpunimin ndëretnik. Një shembull i tillë është, i ashtuquajtur i bashkim i votave (vote pooling), situatë në të cilën partitë etnike i shkëmbejnë votat, gjegjësisht, që të fitojnë vota nga komunitetet e tjera ato janë të detyruar t’i zbusin qëndrimet e tyre.

Që ta zbusim gjendjen, është e nevojshme të ridefinohet modeli zgjedhor për zgjedhje presidenciale. Një nga opsionet është që në zgjedhjet e ardhshme të aplikohen disa aspekte të sistemit integruar. Për shembull, mund të aplikohet model zgjedhor për zgjedhjen e presidentit i ngjashëm me atë të Nigerisë nga viti 1978.⁶⁰

60 Shiko Horowitz. 1985. Ethnic groups in conflict. Berkeley: University of California Press.

Për shembull, nëse Kuvendi do të miratonte amendamente të ligjit zgjedhor të cilat do të precizonin se për t'u zgjedhur kandidati për president duhet të ketë një përqindje të caktuar të votave nga të gjitha njësitet zgjedhore, duke përfshirë këtu dhe ato ku shqiptarët e Maqedonisë janë ose shumicë ose në numër të madh, atëherë do të arrihej efekti i maturisë në agjendën zgjedhore të kandidatit maqedonas pa pasur përcaktim formal që do ta udhëhiqte zyrën e zëvendëspresidentit. Që tani duhet të diskutohet për atë se cilat mekanizma zgjedhore mund të aplikohen në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 që të nxitet bashkëpunimi i partive përfaqësuese të komuniteteve të ndryshme etnike.

Sipas teorisë integruese të Horovicit për zbutjen e tensioneve etnike, sugjerohet të shfrytëzohet sistem zgjedhor i shumicës me „votë alternative” (alternative vote). Sipas këtij modeli, votuesit gjatë zgjedhjeve i rangojnë kandidatët sipas preferencave. Nëse kandidati fiton shumicë absolute të preferencave që janë radhitur si të para, ai/ajo është i zgjedhuri në atë vendvotim. Nëse asnjë kandidat nuk fiton shumicë absolute (më shumë se gjysmën) e preferencave të radhitura si të parat, atëherë i radhituri i fundit eliminohet dhe fletëvotimet që e radhisin të parin atë kandidat rishikohen dhe llogariten preferencat e tyre të radhitura si të dyta, të cilat u shpërndahen kandidatëve përkatës. Nëse sërish nuk ka kandidat me shumicë absolute të votave, procedura përsëritet derisa ndonjëri nga kandidatët të fitojë shumicë absolute.

Idea e Horovicit është se kandidatët, gjegjësisht partitë që i propozojnë, do të duhet të jenë të matur dhe bashkëpunues në një sistem zgjedhor të tillë, sepse jo vetëm zgjedhja e parë por dhe zgjedhja e dytë dhe e tretë janë të rëndësishme. Në sistem zgjedhor me parti që përfaqësojnë komunitete të ndryshme etnike, ato do të varen nga votat e grupit tjetër etnik, që vetë më vete është motiv i rëndësishëm për fushata dhe programe të matura. Ky mekanizëm ku është me rëndësi „të fitohen vota nga i gjithë spektri i ndarjeve etnike dhe religjioze, ku përmes marrëveshjeve me parti të tjera tregtohen preferencat e dyta, të treta dhe të katërta, kërkon sjellje të matur gjithëpërfshirëse sa u përket temave dhe problemeve etnike”⁶¹ Në këtë rast, Maqedonia duhet ta ndryshojë sistemin zgjedhor nga ai proporcional në sistem të shumicës.

Nënkuptohet që kjo çështje është e hapur për debat. Është i rëndësishëm vlerësimi se a normalizohet gradualisht gjendja në Maqedoni dhe a ekziston rrezik nga përkeqësimi i sërishëm i marrëdhënieve etnike mes maqedonasve dhe shqiptarëve të Maqedonisë. Në thelb, si rregull i përgjithshëm duhet të respektohet parimi liberal se institucionet e shtetit u shërbejnë interesave të qytetarëve dhe se arsyetimi i funksionimit ose ekzistimit të tyre duhet të jetë i lidhur ngushtë me interesat dhe nevojat e qytetarëve. Nëse konsiderohet se reformat institucionale të lartpërmendura i nevojiten Maqedonisë, ato duhet të përkrahen. Duke pasur parasysh atë që paraqitet në këtë analizë, konsiderojmë se marrëdhëniet ndëretnike dhe përplasjet partiake janë radikalizuar dhe kështu na nevojiten teknika të tilla për parandalim të konflikteve etnike.

61 Horowitz, D. L. A Democratic South Africa? Constitutional Engineering in a Divided Society. Berkeley, CA: University of California Press 1991, faqe 177.

ANEKSI 1

PLATFORMA e BDI-së, Aleancës për Shqiptarët dhe Besës (e ashtuquajtur Platforma e Tiranës)

1. Arritja e barazisë së plotë në pajtim me Marrëveshjen e Ohrit dhe Kushtetutën

* Zbatim i drejtë i parimit të multietnicitetit në Kushtetutën e RM-së, ku shqiptarët llogariten si komb shtetformues, mbështetjen e çfarëdo nisjeje ligjore dhe kushtetuese e cila e përmirëson barazinë kombëtare për shqiptarët e Maqedonisë.

* Arritje e barazisë së plotë gjuhësore, përdorimi i gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe garanci për zbatimin e saj si e drejtë themelore dhe kushtetuese. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë duhet të përcaktojë se “gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj janë gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë”.

* Debat gjithëpërfshirës për flamurin, himnin dhe stemën e Republikës së Maqedonisë me qëllim që të reflektojnë multietnicitet shoqëror dhe barazi etnike.

* Miratimi i Rezolutës në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me të cilën dënohet gjenocidi mbi kombin shqiptar në Maqedoni në periudhën 1912-1956.

2. Arritja e barazisë ekonomike dhe e mirëqenies shoqërore, sidomos nëpërmjet zhvillimit të barabartë rajonal

* Krijimi i një mekanizmi të ri, në formën e Komisionit shtetëror për financim të komunave, për një vendimmarrje më të drejtë për grante qeveritare në dobi të komunave.

* Krijimi i një Ministrie për sistem publik dhe marrëdhënie midis komuniteteve, si organ përgjegjës për respektimin e të drejtave të komuniteteve dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në zonat e pazhvilluara.

* Realizimi i përfaqësimit të drejtë në organet e sigurisë, ushtrisë, inteligjencës dhe të drejtësisë.

* Realizimi i përfaqësimit të drejtë në të gjitha nivelet e pushtetit qendror si dhe në agjencitë publike ose ndërmarrjet me aksione publike.

3. Përforsimi i sundimit të së drejtës, si parakusht për ecurinë e procesit të integritetit euro-atlantik

* Zbatimi i reformave në përputhje me Marrëveshjen e Shkupit, Rekomandimet e Pribesë, rekomandimet urgjente të Komisionit Evropian si dhe Rekomandimet nga Dialogu i lartë parainkuadruar me BE-në.

* Përkrahje e punës së paanshme të Prokurorisë Speciale, pa paragjykimet etnike dhe politike.

* Zbardhja e plotë e çështjeve dhe proceseve gjyqësore si „Sopot”, „Brodec”, „Monstra” dhe „Kumanova” nëpërmjet një komisioni hetimor ose një trupi të pavarur ndërkombëtar.

4. Krijimi i një fryme mirëbesimi në funksion të marrëdhënieve të mira ndëretnike si element thelbësor për stabilitetin politik në vend

- * Marrja e masave afirmative për të siguruar financimin e institucioneve kulturore shqiptare në nivel vendor dhe qendror.
- * Krijimi i një institucioni qendror për avancimin e gjuhëve të komuniteteve, i cili do të sigurojë përgatitjen e përkthyesve, redaktorëve dhe lektorëve.

5. Zgjidhja e çështjes së emrit në përputhje me vlerat evropiane dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare

- * Miratimi i një Rezolute të përbashkët dhe detyruese në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me të cilën Qeveria e Republikës së Maqedonisë angazhohet në mënyrë aktive në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit.
- * Përfshirja e shqiptarëve në grupin e punës për bisedime të drejtpërdrejta me Greqinë.

6. Marrëdhënie të mira me fqinjët

- * Përfshirja e shqiptarëve në grupin e punës për bisedime të drejtpërdrejta me Bullgarinë.
- * Bashkëpunim me Kosovën dhe Shqipërinë për menaxhimin e integruar të kufijve.
- * Hapja e pikave të reja kufitare.

7. Integrim i shpejtë në NATO dhe Bashkimin Evropian

- * Përmbytja e pikave të lartpërmendura do ta zhbllokojë rrugëtimin e Maqedonisë drejt integrimit të plotë në NATO dhe hapjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
- * Përmbytja e këtyre qëllimeve do të ndiqet përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta të partive parlamentare shqiptare.